



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 46	2001	Tetor
---------------	-------------	--------------

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
	Rezolutë e Kuvendit	1435
Dekret nr. 3090 datë 20.9.2001	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare	1436
Dekret nr.3109 datë 2.10.2001	Për emërimin e anëtarit të Gjykatës së Lartë	1437
Akt normativ nr.6 datë 3.9.2001	Për disa ndryshime në ligjin nr. 8718 datë 19.12.2000 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2001”.....	1438
Vendim i KM nr.531, datë 24.9.2001	Për miratimin e uniformës dhe të emblemsë së shërbimit doganor	1444
Vendim i KM nr.532, datë 24.9.2001	Për disa ndryshime në vendimin nr.439, datë 4.8.2000, të Këshillit të Ministrave “Për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”	1447

Vendim i KM nr.534, datë 24.9.2001	Për trajtimin me shpërblim të punonjësve që shkurohen nga kalimi në koncension i Minierës së Kromit Bulqizë, Fabrikës së Pasurimit Bulqizë, Impiantit të Seleksionimit Klos dhe Uzinës së Ferrokromit Burrel.....	1448
Vendim i GjK nr.98 , datë 27.7.2001	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.200, datë 25.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.....	1451
Vendim i GjK nr.100, datë 31.7.2001	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.203, datë 25.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe shpalljen e pavlefshme të votimeve të datës 22.7.2001 në qendrat e votimit nr.5 Abat, nr.7 Nikaj, nr.9 Menmavriq, nr.14 Prekal, nr.6 Benë dhe nr.9 Toplan të zonës zgjedhore.....	1450
Vendim i GjK nr.101, datë 31.7.2001	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.192, datë 23.7.2001 dhe nr.193, datë 23.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve....	1452
Vendim i GjK nr.103, datë 10.8.2001	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.996, datë 29.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe përsëritjen e zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.10.....	1456
Vendim i GjK nr.104, datë 31.7.2001	Me objekt kundërshtimi i vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr.206, datë 27.6.2001.....	1458
Vendim i GjK nr. 111, datë 13.8.2001	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.219, datë 8.8.2001 dhe nr.221, datë 9.8.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe përsëritjen e zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.10.....	1460
Vendim i GjK nr.112, datë 13.8.2001	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.220, datë 8.8.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.13.....	1463
Vendim i GjK nr.114, datë 27.8.2001	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.233, datë 21.8.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.....	1464
Vendim i GjK nr.115, date 28.8.2001	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.232, datë 21.8.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për shpalljen e listës së deputetëve të koalicionit "Bashkimi për Fitore",të cilët përfitojnë nga ndarja e mandateve plotësuese".....	1467
Vendim i GjK nr. 116, datë 28.8.2001	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.230, datë 21.8.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	1469

REZOLUTË

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, pas tragjedisë së shkaktuar si rrjedhojë e sulmeve terroriste mbi Nju Jork dhe Uashington D.C. më 11 shtator 2001, si dhe duke vlerësuar ndikimet e mundshme mbi rendin dhe sigurinë globale:

1. ndan dhimbjen dhe shpreh solidaritetin më të thellë me popullin amerikan dhe familjet e viktimave;

2. dënon ashpërsisht këto akte terroriste barbare të kryera mbi civilë të pafajshëm dhe simbolet e demokracisë dhe i konsideron ato dhunim flagrant të së drejtës më themelore të individit, të drejtën për jetën, si dhe i cilëson ato si një agresion kundër vlerave të lirisë dhe demokracisë në botë;

3. shpreh gatishmërinë dhe vendosmërinë për të mbështetur dhe bashkëpunuar me Qeverinë e SHBA-së dhe aleancën e vendeve demokratike në luftë kundër terrorizmit, për të nxjerrë përpara drejtësisë e për të ndëshkuar përgjegjësit e këtyre krimeve të përbindshme, si dhe për të çrrënjësuar shkaqet e tyre;

4. vlerëson se ky lloj terrorizmi, që nuk njeh kufij, duhet të neutralizohet mbi bazën e një zgjidhjeje komplekse globale, politike, institucionale etj. dhe të krijimit të një koalicioni ndërkombëtar efikas për këtë qëllim;

5. konsideron se akte të tilla terroriste frymëzohen nga grupe të caktuara ekstremiste, të cilat përmes një shtrembërimi të qëllimshëm të parimeve fetare për justifikimin e dhunës, synojnë të provokojnë një përplasje midis Perëndimit dhe Botës Islamike.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, nisur nga angazhimet që burojnë nga anëtarësia e Shqipërisë në organizmat ndërkombëtarë, dypalëshe dhe me organizmat euroatlantikë e të sigurisë rajonale, i kërkon Qeverisë Shqiptare të intensifikojë përpjekjet për bashkërendimin e veprimeve të të gjitha institucioneve të shtetit në luftën kundër veprimeve terroriste, krimet të organizuar dhe të gjitha llojeve të trafikeve.

Në këtë kuadër, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në bashkëpunim me Qeverinë:

-të rishikojë të gjithë kuadrin ligjor ekzistues kundër akteve terroriste, me synim parandalimin dhe goditjen e fuqishme të terrorizmit;

- të ndërmarrë të gjitha veprimet për plotësimin e procedurës së nevojshme për ratifikimin e konventave antiterroriste ekzistuese dhe, në mënyrë të veçantë, Statusin e Romës për Gjykatën Penale Ndërkombëtare dhe Marrëveshjen Ndërkombëtare për Goditjen e Financimeve të Terrorizmit.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë të monitorojë përmbushjen e detyrimeve, që rrjedhin nga të gjitha konventat ekzistuese të ratifikuara në luftën kundër terrorizmit dhe të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për plotësimin e kuadrit ligjor në këtë drejtim, duke respektuar e zhvilluar më tej liritë dhe të drejtat e njeriut.

Tiranë, më 26.9.2001

D E K R E T **Nr. 3090, datë 20.9.2001**

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të neneve 15,19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

D E K R E T O J:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Rozeta Avdurahman Gega (Haxhiu)
2. Amanda Halit Gega
3. Felicia Halit Gega

4. Jezerca Halit Gega
5. Gazmend Fazlli Bana
6. Elson Gazmend Bana
7. Nils Gazmend Bana
8. Edmonda Agim Bana (Gjikola)
9. Selim Rasim Spanjolli
10. Arjana Xhafer Mema (Ago)
11. Ilir Ali Dervishi
12. Arens Tonin Berisha
13. Arben Ramazan Karaj
14. Elton Arben Karaj
15. Barbara Arben Karaj
16. Maik Arben Karaj
17. Anila Bajram Karaj (Dyrmishi)
18. Elmas Laver Hyseni
19. Amorina Elmas Hyseni
20. Jakomo Elmas Hyseni
21. Cindy Elmas Hyseni
22. Albana Lavdosh Hyseni (Bedini)
23. Skënder Nuredin Mehmeti
24. Sara Skënder Mehmeti
25. Zana Novruz Mehmeti (Osmani)
26. Qazim Etem Shehu
27. Donika Sophie Qazim Shehu
28. Dominik Philipp Qazim Shehu
29. Entela Rrapo Shehu (Tahirllari)
30. Adrian Haxhi Gega
31. Xhulia Adrian Gega
32. Paola Adrian Gega
33. Ardiana Shuaip Gega (Rexho)
34. Shkëlqim Islam Zekthi
35. Majlinda Andon Zekthi (Kostreci)
36. Gjyljana Shkëlqim Zekthi
37. Dritan Shkëlqim Zekthi
38. Klodiana Petraq Nettersheim (Dulja)
39. Rudina Emin Reçi (Teichmann)
40. Agim Jaho Bajrami
41. Dashamira Ramadan Bajrami (Zonja)
42. Jessi Sara Agim Bajrami
43. Klea Agim Bajrami
44. Teuta Shyqyri Shima (Gega)
45. Esat Muharrem Shima
46. Enton Esat Shima
47. Jonas Esat Shima

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Rexhep Meidani

D E K R E T
Nr.3109, datë 2.10.2001

PËR EMËRIMIN E ANËTARIT TË GJYKATËS SË LARTË

Në mbështetje të nenit 136 pika 1 të Kushtetutës, bazuar në pëlqimin e dhënë nga Kuvendi, me vendimin nr.6, datë 27.9.2001.

D E K R E T O J:

Neni 1

Zoti Spiro Spiro emërohet anëtar i Gjykatës së Lartë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Rexhep Meidani

A K T N O R M A T I V
Nr.6, datë 3.9.2001

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8718 DATË 19.12.2000
“PËR BUXHETIN E SHTETIT TË VITIT 2001”

Në mbështetje të neneve 101 të Kushtetutës dhe të nenit 31 e 32 të ligjit nr. 8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”,

KËSHILLI I MINISTRAVE
V E N D O S I:

Në ligjin nr. 8718, datë 19.12.2000 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2001” bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 1 ndryshon si më poshtë:
“Fondi i konsoliduar për vitin 2001 është:

Të ardhurat e Buxhetit të Shtetit	118.792 milionë lekë
Shpenzimet e Buxhetit të Shtetit	173.326 milionë lekë
Deficiti	54.534 milionë lekë
i cili përbëhet:	
A) Buxheti qendror	
Të ardhurat	117.192 milionë lekë
Shpenzimet	171.726 milionë lekë
B) Buxheti i pavarur i pushtetit vendor	
Të ardhurat	6.470 milionë lekë
Nga të cilat:	
Granti nga Buxheti qendror	4.870 milionë lekë
Shpenzimet	6.470 milionë lekë”

Neni 2

Neni 2 ndryshon si më poshtë:

“Buxheti i Sigurimeve Shoqërore për vitin 2001 është:

A. Skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror

Të ardhurat gjithsej 31.657 milionë lekë

- Nga kontributet 20.770 milionë lekë

- Nga teprica e fondit të vitit 2000 340 milionë lekë

- Transferimet nga Buxheti i Shtetit 10.547 milionë lekë

Shpenzimet 31.657 milionë lekë

Paga minimale për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore është 8.396 lekë në muaj.”

Neni 3

Neni 4 ndryshon si vijon:

“Të ardhurat e Buxhetit të Shtetit, sipas grupeve kryesore janë:

Të ardhurat tatimore 93.900 milionë lekë

Të ardhurat jotatimore 23.292 milionë lekë

Të ardhurat e buxhetit vendor 1 600 milionë lekë”

Neni 4

Neni 5 ndryshon si vijon:

“Kufiri maksimal i financimit të deficitit të buxhetit të përgjithshëm nga burime të brendshme është 27.813 milionë lekë. Të ardhurat nga privatizimi përdoren për financimin e deficitit në masën 10.000 milionë lekë dhe për mbështetjen e sektorit të energjisë elektrike në masën 2.400 milionë lekë.

Kufiri i financimit nga burimet e huaja është 26.721 milionë lekë, nga i cili mbështetja e drejtpërdrejtë për deficitin është 4.640 milionë lekë.”

Neni 5

Neni 7 ndryshon si vijon:

“Shpenzimet sipas drejtimeve kryesore janë:

- Shpenzime korrent 19.123 milionë lekë

- Shpenzimet kapitale 44.739 milionë lekë

- Kosto e ristrukturimit të bankave 3.010 milionë lekë

- Rezerva e Këshillit të Ministrave 3.904 milionë lekë

- Kontigjenca 2.550 milionë lekë

Kufiri i shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion, i ndarë në fonde të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara, është sipas Tabelës B 1, bashkëngjitur.”

Neni 6

Neni 9 ndryshon si vijon:

“Shpenzimet kapitale nga burimet e brendshme janë 21.239 milionë lekë dhe nga burime të huaja 23.500 milionë lekë. Investimet sipas ministrive dhe institucioneve paraqiten në Tabelën B.2, bashkëngjitur.”

Neni 7

Neni 10 ndryshon si vijon:

“Fondi i kontigjencës prej 2.550 milionë lekësh do të përdoret:

- Për ruajtjen e deficitit, me miratim të Kuvendit 1.000 milionë lekë.

- Me vendim të Këshillit të Ministrave, 1.200 milionë lekë për rritjen e investimeve në zërat, TVSH, taksë doganore, kosto lokale dhe shpronësime, në përputhje me ecurinë e financimeve të huaja, në rast se fondet e akorduara për këtë qëllim, sipas Tabelës B 2, nuk janë të mjaftueshme.
- Dhe 350 milionë lekë për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare.”

Neni 8

Neni 15 ndryshon si vijon:

“Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të borxhit të shtetit, si dhe atij të garancive të shtetit në dobi të palëve të treta përfituese është si më poshtë:

1. Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të borxhit të shtetit është 62.013 milionë lekë, nga i cili:

- Për kreditë e jashtme të drejtpërdrejta të Këshillit të Ministrave është 15 000 milionë lekë dhe për kredi të jashtme të vjetra që do të riskedulohen 23 600 milionë lekë;
- Për financimin e brendshëm të deficitit buxhetor është 17 413 milionë lekë;
- Për borxhet e brendshme ndaj të tretëve që merren përsipër nga Këshilli i Ministrave është 6.000 milionë lekë.

2. Kufiri për rritjen vjetore të garancive të shtetit në dobi të palëve të treta përfituese është 4.900 milionë lekë.”

Neni 9

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

TREGUESIT FISKALË SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR (Fiscal Indicators regarding consolidated budget) në milion lekë (in milion of leks)								
Nr.	Emërtimi	1999	Plan 2000	Fakt 2000	Plan 2001	Ndrysh. 2001	Projekt 2001	
	TOTALI TË ARDHURAVE	107,506	123,617	120,588	136,462	5,315	141777	TOTAL REVENUE
I.	Të ardhura nga fondi kundërpartit	155						Counterpart funds
II.	Të ardhura tatimore gjithsej	65,401	83,625	84,045	94,900	600	95500	Total Tax Revenue
II.1	Nga Tatimet dhe doganat	64,516	82,375	82,730	93,300	600	93900	From tax offices and customs
1	Tatimi mbi vlerën e shtuar	29,794	39,385	38,107	44,160		44160	V.A.T&Turnover Tax
2	Tatimi mbi fitimin	6,033	6,200	8,115	8,350		8350	Profit Tax
3	Akcizat	6,961	9,350	9,153	11,210		11210	Excise Tax
4	Tatimi mbi Biznesin e Vogël	1,188	1,750	1,641	2,300		2300	Small Business Tax
5	Tatimi mbi të ardhurat personale	3,138	4,100	4,590	5,650		5650	Personal Income Tax
6	Taksa Nacionale dhe të tjera	5,952	7,550	7,576	8,100		8,100	National Taxes and others
6.1	Taksa Nacionale	3,594	4,000	5,099	6,100		6100	National Taxes
6.2	Taksë solidariteti	1,940	2,200	1,793	1,200		1200	Solidarity Tax
6.3	Të tjera në doganë plus lojra fati	418	1,350	684	800		800	Others in Customs+Tax on Gamble
7	Taksa doganore	11,450	14,040	13,548	13,530		13530	Customs Duties
II.2	Të ardhura nga Pushteti Lokal	885	1,250	1,315	1,600	0	1600	Revenues from Local Gov
	Tatimi mbi Pasurinë	181	500	190	400		400	Property Tax
	Taksa lokale	704	750	1,126	1,200		1200	Local Taxes
III	Të ardh.Buxh.Pavarur	18,165	19,596	20,053	22,585	400	22985	Social.Ins.contributions

	(Kontribute)							
1	Sigurimi Shoqërore	16,814	17,896	18,523	20,735	400	21135	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetësor	1,351	1,700	1,530	1,850		1850	Health Insurance
IV.	Të ardhura Jotatimore	23,785	20,396	16,490	18,977	4,315	23292	Nontax Revenue
1	Tran.fitmi nga Banka e Shqipërisë	17,591	10,600	10,225	9,100	2,200	11300	Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	5,041	6,799	4,841	6,302	2,115	8417	Income of budgetary institutions
3	Të tjera	1,153	2,997	1,424	3,575		3575	Other/not allocates
	TOTALI I SHPENZIMEVE	165,692	175,844	169,423	190,496	5,815	196311	TOTAL EXPENDITURE
I	Shpenzime Korrente	131,111	130,512	133,613	137,633	4,475	142108	Current Expenditures
1	Personeli	31,183	32,37	33,240	39,752	1,478	41230	Personnel expenditures
	Paga	24,207	25,217	25,820	31,563		31563	Wages
	Kontributi për Sigurime Shoqërore	6,976	7,520	7,420	8,189		8189	Social insurance contributions
2	Interesat	34,938	9,672	29,849	23,938	-180	23758	Interest
	Të brendshme	34,355	28,156	27,524	21,900		21900	Domestic
	Të huaja	583	1,516	2,325	2,038	-180	1858	Foreign
3	Shpenzime Operative	20,072	20,380	19,294	18,304	367	18671	Operational&Maintenance
	Mirëmbajtjeje							
4	Subvencionet	2,704	2,690	5,247	5,307	2,410	7717	Subsidies
5	Shpenz. Sig.Soc.e transf. të tjera	27,609	31,110	31,375	35,412	300	35712	Social Insurance Outlays
	Sigurime Shoqërore	25,017	28,110	28,948	32,362	300	32662	Social Insurance
	Sigurime Shëndetësore	2,592	3,000	2,427	3,050		3050	Health Insurance
6	Local Government Expenditure	6,285	5,263	6,028	6,470	0	6470	Local Government Expenditure
	Buxheti lokal (Granti)	5,134	4,013	4,595	4,870		4870	Local Budget (Grant)
	Buxheti lokal (Të ardhurat e veta)	1,151	1,250	1,433	1,600		1600	Local Budget (Local revenues)
7	Shpenzime të tjera	8,320	8,660	8,580	8,450	100	8550	Other expenditures
	Pagesa e papunësisë	1,450	1,600	1,919	1,700		1700	Unemployment insurance benefits
	Ndihma Ekonomike	6,360	6,890	6,661	6,750	100	6850	Social assistance
	Kompensim për të përndjekurit politike				0		0	Comens for the political persec
	Subvencion për të pastrehët	510	170	0	0		0	Housing subsidy
II	Fondi Rezervë	0	6,193	0	5,950	504	6454	Reserve fund/contingency
III	Shpenzime Kapitale	34,120	37,109	35,062	43,903	836	44739	Capital Expenditures
	Financimi Brendshëm	16,963	17,109	18,735	20,403	836	21239	Domestically Financed
	Local Budget Capital Grant						0	Local Budget Capital Grant
	Financimi i Huaj	17,158	20,000	16,327	23,500		23500	Foreign Financed
IV	Kosto Int. të rristur. të Bankës	461	2,030	748	3,010	0	3010	Cost of Bank Restructuring
	DEFICITI	-58,186	-52,227	-48,835	-54,034	-500	(54534)	Deficit
	FINANCIMI I	58,186	52,227	48,835	54,034	500	54534	Financing (Cash)
	DEFICITIT							
	Brendshëm	27,928	27,152	26,849	27,313	500	27813	Domestic
	Të ardhura nga Privatizimi	906	7,000	8,975	8,800	3,600	12400	Privatization receipts
	Të tjera	27,022	20,152	17,874	18,513	-1,100	17413	Other
	Ripagesat					-2,000	(2000)	
	I Huaj	30,257	25,075	21,988	26,721	0	26721	Foreign
	Për zhvillim	17,158	20,000	16,327	23,500	0	23500	Development (gross)
	Mbështetje për Buxhetin dhe të tjera	13,950	6,291	6,660	4,640	0	4640	Budget support and others
	Nga e cila mbështetje për buxhetin	11,960	6,291	6,660	4,640		4640	From which Budget support
	Ripagesat	-851	-1,216	-999	-1,418		(1418)	Repayments
	KAPITUJT						0	Main Indicators
	KRYESORE						0	

	Financimi i Brendshëm i Deficitit	27,928	27,152	26,849	27,313	500	27813	Domestically financed deficit
	Të Ardh.Brend.minus Shp.Brend	-41,028	-32,227	-32,508	-30,534	-500	(31034)	Domestic revenues-dom.exp.
	Deficiti i Përgjithshëm	-58,186	-52,227	-48,835	-54,034	-500	(54534)	Overall Balance
							0	
TREGUESIT FISKALË SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR (Fiscal indicators regarding consolidated budget.) në % të Prodhimit të Brendshëm Brut (%of GDP)								
Nr	Emërtimi	1999	Plan 2000	Fakt 2000	Plan 2001	Ndrysh 2001	Projekt 2001	
	TOTALI I TË	21.2%	22.6%	22.4%	23.0%	0.9%	23.9%	TOTAL REVENUE
I.	ARDHURAVE	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	Counterpart funds
II.	Të ardhura nga fondi kundërparti	12.9%	15.3%	15.6%	16.0%	0.1%	16.1%	Total Tax Revenue
II.1	1 Të ardhura tatimore	12.7%	15.1%	15.3%	15.7%	0.1%	15.8%	From tax offices and customs
2	gjithsej	5.9%	7.2%	7.1%	7.4%	0.0%	7.4%	V.A T& Turnover Tax
3	gjithsej	1.2%	1.1%	1.5%	1.4%	0.0%	1.4%	Profit Tax
4	Nga tatimet dhe doganat	1.4%	1.7%	1.7%	1.9%	0.0%	1.9%	Excise Tax
5	Tatimi mbi vlerën e shtuar	0.2%	0.3%	0.3%	0.4%	0.0%	0.4%	Small Business Tax
6	Tatim mbi fitimin	0.6%	0.8%	0.9%	1.0%	0.0%	1.0%	Personal Income Tax
6.1	Akcizat	1.2%	1.4%	1.4%	1.4%	0.0%	1.4%	National Taxes and others
6.2	Tatimi mbi biznesin e vogël	0.7%	0.7%	0.9%	1.0%	0.0%	1.0%	National Taxes
6.3	Tatimi mbi biznesin e vogël	0.4%	0.4%	0.3%	0.2%	0.0%	0.2%	Solidarity Tax
7	Tatimi mbi të ardhurat personale	0.1%	0.2%	0.1%	0.1%	0.0%	0.1%	Others in Customs+Tax on
II.2	Taksa nacionale dhe të tjera	2.3%	2.6%	2.5%	2.3%	0.0%	2.3%	Customs Duties
III.	Taksa nacionale	0.2%	0.2%	0.2%	0.3%	0.0%	0.3%	Revenues from Local Gov.
	Taksë solidariteti	0.1%	0.1%	0.2%	0.2%	0.0%	0.2%	Property Tax
1	Të tjera në doganë plus	3.3%	3.6%	3.7%	3.8%	0.1%	3.9%	Local Taxes
2	lojra fati	0.3%	0.3%	0.3%	0.3%	0.0%	0.3%	Social ins.
IV.	Taksa doganore	0.3%	0.3%	0.3%	0.3%	0.0%	0.3%	Contributions
1	Të ardhura nga Pushteti	4.7%	3.7%	3.1%	3.2%	0.7%	3.9%	
2	Lokal	3.5%	1.9%	1.9%	1.5%	0.4%	1.9%	Social insurance
3	Tatime mbi pasurinë	1.0%	1.2%	0.9%	1.1%	0.4%	1.4%	Health insurance
	Taksa lokale	0.2%	0.5%	0.3%	0.6%	0.0%	0.6%	Nontax Revenue
	Të ardh Buxh. Pavarur (kontribute)	32.7%	32.2%	31.4%	32.1%	1.0%	33.0%	Profit transfer from BOA
I.	1 Sigurimi Shoqëror	25.9%	23.9%	24.8%	23.2%	0.8%	23.9%	Income of budgetary institutions
	Sigurimi Shëndetësor	6.2%	6.0%	6.2%	6.7%	0.2%	6.9%	Other/not allocated
	Të ardhura Jotatimore	4.8%	4.6%	4.8%	5.3%	0.0%	5.3%	
2	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë	1.4%	1.4%	1.4%	1.4%	0.0%	1.4%	
3	Të ardhura nga Inst. Buxhetore	6.9%	5.4%	5.5%	4.0%	0.0%	4.0%	
4	Të tjera	6.8%	5.2%	5.1%	3.7%	0.0%	3.7%	
5		0.1%	0.3%	0.4%	0.3%	0.0%	0.3%	
	Të ardh Buxh. Pavarur (kontribute)	4.0%	3.7%	3.6%	3.1%	0.00.1%	3.1%	TOTAL EXPENDITURE
I.	1 Sigurimi Shoqëror	0.5%	0.5%	1.0%	0.9%	0.4%	1.3%	Current Expenditures
	Sigurimi Shëndetësor	5.5%	5.7%	5.8%	6.0%	0.1%	6.0%	Personnel expenditures
	Të ardhura Jotatimore	4.9%	5.1%	5.4%	5.4%	0.1%	5.5%	Wages
2	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë	0.5%	0.5%	0.5%	0.5%	0.0%	0.5%	Social insurance contributions
3	Të ardhura nga Inst. Buxhetore	1.2%	1.0%	1.1%	1.1%	0.0%	1.1%	Interest
4	Të tjera	1.0%	0.7%	0.8%	0.8%	0.0%	0.8%	Domestic
	Të ardh Buxh. Pavarur (kontribute)	0.2%	0.2%	0.3%	0.3%	0.0%	0.3%	Foreign
I.	1 Sigurimi Shoqëror	1.6%	1.6%	1.6%	1.4%	0.0%	1.4%	Operational & Maintenance
	Sigurimi Shëndetësor	0.3%	0.3%	0.4%	0.3%	0.0%	0.3%	
	Të ardhura Jotatimore	1.3%	1.3%	1.2%	1.1%	0.0%	1.2%	
2	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	Subsidies
3	Të ardhura nga Inst. Buxhetore	0.1%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	Social insurance outlays
4	Të tjera	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	Social insurance
	Të ardh Buxh. Pavarur (kontribute)	0.1%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	Health insurance
I.	1 Sigurimi Shoqëror	6.7%	6.8%	6.5%	7.4%	0.1%	7.5%	Local Government
	Sigurimi Shëndetësor	3.4%	3.1%	3.5%	3.4%	0.1%	3.6%	Expenditure
	Të ardhura Jotatimore	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	Local Budget (Grant)
2	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë	3.4%	3.7%	3.0%	4.0%	0.0%	4.0%	Local Budget
3	Të ardhura nga Inst. Buxhetore	0.1%	0.4%	0.1%	0.5%	0.0%	0.5%	(compensation)
4	Të tjera							Other expenditures

Buxheti lokal (Grand)	-11.5%	-9.6%	-9.1%	-9.1%	-0.1%	-9.2%	Unemployment insurance benefits
Buxheti lokal (Të ardhurat e veta)	11.5%	9.6%	9.1%	9.1%	0.1%	9.2%	Social assistance
Shpenzime të tjera	5.5%	5.0%	5.0%	4.6%	0.1%	4.7%	Compens for the political persec
Pagesa e papunësisë	0.2%	1.3%	1.7%	1.5%	0.6%	2.1%	
Ndihma ekonomike	5.3%	3.7%	3.3%	3.1%	-0.2%	2.9%	
Kompensim për të përndjekurit politikë					-0.3%	-0.3%	Housing subsidy
Subvencion për të pastrehët	6.0%	4.6%	4.1%	4.5%	0.0%	4.5%	Reserve
Fondi Rezervë	3.4%	3.7%	3.0%	4.0%	0.0%	4.0%	fund/contingency
Shpenzime Kapitale	2.8%	1.2%	1.2%	0.8%	0.0%	0.8%	Capital expenditures
Financimi i Brendshëm	2.4%	1.2%	1.2%	0.8%	0.0%	0.8%	Domestically financing
Local Budget Capital Grant	-0.2%	-0.2%	-0.2%	-0.2%	0.0%	-0.2%	Local Budget Capital Grant
Financimi i Huaj	5.5	5.0%	5.0%	4.6%	0.1%	4.7%	Foreign financed
Kosto Int. të ristruktur. të Bankës	-8.1	-5.9%	-6.0%	-5.1%	-0.1%	-5.2%	Cost of Bank Restructuring
DEFICITI	-11.5	-9.6%	-9.1%	-9.1%	-0.1%	-9.2%	Cash balance
FINANCIMI DIFICITIT							Fianancing (Cash)
Brendshëm							Domestic
Të ardhura nga Privatizimi							Privatizationreceipts
Të tjera							Other
I HUAJ							Foreign
Për zhvillim							Development (gross)
Mbështetje për buxhetin dhe të tjera							Budget Support and others
Nga e cila mbështetje për buxhetin							From which Budget support
Ripagesat							Repayments
KAPITUJ KRYESORË							Main indicators
Financimi i Brendshëm i Deficitit							Domestically financed deficit
Të Ardh. Brend. Minus Shp. Brend.							Domestic revenues-dom.exp
Deficiti Përgjithshëm							Overall Balance
Prodh. Brend. Brut. Në milionë lekë		506205	545847	539210	594346	594346	594346
GDP. In million lek							

në.000 lekë

Investime sipas institucioneve 2001					
	Ministria ose Institucioni	Nga buxheti	Nga të Ardhurat	Fin.Huaja	Totali
1	Presidenca	10,000	40	0	10.040
2	Kuvendi	25,000	0	0	25,000
3	Këshilli i Ministrave	107,000	12,000	213,000	332,000
4	Min.e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit	1,825,000	12,150	0	1,837,150
5	Min.e Bujqësisë dhe Ushqimit	1,300,000	24,200	2,583,000	3,907,200
6	Min.e Punëve Publike	2,790,000	7,140	3,800,000	6,597,140
7	Min.e Bashkpunim.Ekonomik dhe Tregtisë	250,000	10	1,500,000	1,750,010
8	Min.e Transportit	6,020,000	2,890	6,700,000	12,722,890
9	Zyra e Regjis. të Pasurive të Paluajtshme	12,000	25,200	0	37,200
10	Ministria e Financave	55,000	0	420,000	475,000
11	Min.e Arsimit dhe Shkencës	1,935,000	100,000	1,537,000	3,572,000
12	Min.e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	230,000	70,000	0	300,000
13	Min. e Shëndetësisë	1,400,000	38,750	4,000,000	5,438,750
14	Min.e Drejtësisë	420,000	2,270	282,500	704,770
15	Min. e Punëve të Jashtme	210,000	2,600	0	212,600

16	Min. e Rendit Publik	240,000	235,000	0	475,000
17	Min. e Mbrojtjes	225,000	448,200	0	673,200
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	190,000	5,400	0	195,400
29	Drejtorja e Radio-Televizionit	100,000	0	0	100,000
20	Drejtorja e Arkivit të Shtetit	52,000	2,000	0	54,000
21	Drejtorja e Rezervës së Shtetit	0	25,000	0	25,000
22	Akademia e Shkencave	75,000	7,000	0	82,000
24	Kontrolli i Lartë i Shtetit	10,000	0	0	10,000
25	Min. e Punës, Çështjeve Sociale	205,000	3,000	145,000	353,000
26	Agjensia Kombëtare e Mjedisit	16,000	3,000	140,000	159,000
27	Agjensia Kombëtare e Privatizimit	0	28,000	0	28,000
28	Prokuroria e Përgjithshme	170,000	0	0	170,000
29	Pushteti Gjyqësor	205,000	15,000	0	220,000
30	Gjykata Kushtetuese	31,000	0	0	31,000
31	Agjensia Telegrafike Shqiptare	10,000	6,000	0	16,000
32	Min. e Pushtetit Lokal	600,000	0	0	600,000
35	Drejtorja e Doganave	0	340,000	0	340,000
37	Drejtorja e Standardeve	1,000	1,200	0	2,200
39	Drejtorja e Përgjithshme e Pyjeve	100,000	162,000	629,500	891,500
41	Drejtorja e tatimeve	60,000	150,000	50,000	260,000
50	Instituti i Statistikës	3,000	0	0	3,000
53	Komisioni i Letrave me Vlerë	2,000	1,000	0	3,000
54	Enti Kombëtar i Zonave të Lira	2,000	0	0	2,000
55	Shkolla e Magjistraturës	3,000	100	0	3,100
56	Fondi i Zhvillimit Shqiptar	500,000	0	1,500,000	2,000,000
57	Qendra Kombëtare Kinematografike	1,000	0	0	1,000
59	Ins. i Reha. të të Përndjekurve Politikë	5,000	0	0	5,000
62	Komiteti i Zhvillimit të Turizmit	10,000	5,000	0	15,000
63	Inspek. i Këshillit të Lartë të Drejtësisë	5,000	0	0	5,000
64	Këshilli Kombëtar i RTV	55,000	0	0	55,000
66	Zyra e Avokatit të Popullit	10,000	0	0	10,000
67	Komisioni i Shërbimit Civil	10,000	0	0	10,000
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	20,000	0	0	20,000
	Totali	19,505,000	1,734,150	23,500,000	44,739,150

Buxheti i vitit 2001 sipas ministrive				
	Ministria ose Institucioni	Fonde të pakushtëzuara	Fonde të kushtëzuara	Totali
1	Presidenca	85,732	100	85,832
2	Kuvendi	541,485		541,485
3	Këshilli i Ministrave	474,001	252,000	726,001
4	Min.e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit	7,935,217	176,000	8,111,217
5	Min.e Bujqësisë dhe Ushqimit	2,736,059	2,639,670	5,375,729
6	Min.e Punëve Publike	3,909,620	3,883,845	7,793,465
7	Min. e Bashkpu. Ekonomik dhe Tregtisë	612,380	1,500,050	2,112,430
8	Min.e Transportit	7,820,656	6,707,220	14,527,876
9	Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtsh.	98,980	84,000	182,980
10	Ministria e Financave	3,789,488	422,500	4,211,988
11	Min.e Arsimit dhe Shkencës	16,540,887	1,797,000	18,337,887
12	Min.e Kulturës,Rinisë dhe Sporteve	1,070,788	233,000	1,303,788
13	Min. e Shëndetësisë	11,201,865	4,250,000	15,451,865
14	Min. e Drejtësisë	1,301,797	362,070	1,663,867
15	Min. e Punëve të Jashtme	1,575,948	6,530	1,582,478
16	Min. e Rendit Publik	7,731,336	2,122,000	9,853,336
17	Min. e Mbrojtjes	6,558,000	847,000	7,405,000
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	968,610	27,000	995,610
19	Drejtorja e Radio-Televizionit	600,000		600,000
20	Drejtorja e Arkivit të Shtetit	114,843	10,000	124,843
21	Drejtorja e Rezervës së Shtetit	172,991	40,000	212,991
22	Akademia e Shkencave	429,559	40,000	469,559
24	Kontrolli i Lartë i Shtetit	136,289		136,289
25	Min.e Punës Çështjeve Sociale	21,292,169	281,000	21,573,169
26	Agjensia Kombëtare e Mjedisit	73,470	146,000	219,470

27	Agjensia Kombëtare e Privatizimit	30,205	140,000	170,205
28	Prokuroria e Përgjithshme	788,925	15,000	803,925
29	Pusheteti Gjyqësor	884,958	45,000	929,958
30	Gjykata Kushtetuese	70,181		70,181
31	Agjensia Telegrafike Shqiptare	83,308	15,000	98,308
32	Min.e Pushtetit Lokal	8,553,238		8,553,238
35	Drejtoria e Doganave	512,383	1,011,500	1,523,883
37	Drejtoria e Standardeve	18,743	4,000	22,743
39	Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve	628,063	811,500	1,439,563
40	Parti Politike dhe Shoqata	150,000		150,000
41	Drejtoria e Tatimeve	872,197	530,000	1,402,197
46	Shpenzime për shërbimin e borxhit	23,758,000		23,758,000
48	Drejtoria e Mjeteve Matëse	15,000		15,000
49	Fondi Rezervë	3,904,000		3,904,000
50	Instituti i Statistikës	103,594	250	103,844
53	Komisioni i Letrave me Vlerë	18,000	3,000	21,000
54	Enti Kombëtar i Zonave të Lira	7,582		7,582
55	Shkolla Magjistraturës	34,271	200	34,471
56	Fondi i Zhvillimit Shqiptar	500,000	1,500,000	2,000,000
57	Qendra Kombëtare Kinematografike	96,906	400	97,306
59	Instituti i Rehabilitimit të të Përndjek.Politi.	32,331		32,331
62	Komiteti i Zhvillimit të Turizmit	75,896	21,000	96,896
63	Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë	23,694		23,694
64	Këshilli Kombëtar i RTV	86,000		86,000
66	Zyra e Avokatit të Popullit	83,567		83,567
67	Komisioni i Shërbimit Civil	50,377		50,377
70	Kontigjencat	2,550,000		2,550,000
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	99,208		99,208
	Totali	141,802,797	29,923,835	171,726,632

V E N D I M
Nr.531, datë 24.9.2001

PËR MIRATIMIN E UNIFORMËS DHE TË EMBLEMËS SË SHËRBIMIT DOGANOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 16 të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” me ndryshimet përkatëse, me propozimin e Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e uniformës dhe të emblemës së shërbimit doganor, sipas anekseve 1 dhe 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Efektet financiare që rrjedhin në zbatim të këtij vendimi të përballohen nga buxheti i kushtëzuar i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

3. Ministri i Financave të miratojë “Rregulloren e uniformës së shërbimit doganor”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.


KRYEMINISTRI
Ilir Meta

ANEKSI I
PËRBËRJA DHE NORAMTIVA VJETORE E UNIFORMËS SË PERSONELIT TË
ADMINISTRATËS DOGANORE


Nr.	Emërtimi	Njësia	Personeli doganor (meshkuj)	Personeli doganor (femra)	Personeli i Antikontrabandës
-----	----------	--------	--------------------------------	------------------------------	---------------------------------

1	Xhaketë (ngjyrë blu)	Copë	1 (një)	1 (një)	-
2	Xhakavento (ngjyrë blu)	Copë	-	-	1 (një)
3	Pantallona dimërore (ngjyrë gri)	Palë	2 (dy)	1 (një)	2 (dy)
4	Pantallona verore trikoton (gri)	Palë	2 (dy)	1 (një)	2 (dy)
5	Fund dimëror (ngjyrë gri)	Copë	-	2 (dy)	-
6	Fund veror (ngjyrë gri)	Copë	-	2 (dy)	-
7	Këmishë verore (ngjyrë gri)	Copë	3 (tre)	3 (tre)	3 (tre)
8	Këmishë dimërore (ngjyrë gri)	Copë	3 (tre)	3 (tre)	3 (tre)
9	Kollare (ngjyrë blu)	Copë	2 (dy)	2 (dy)	2 (dy)
10	Pulover me jakë "V" me supanjë dhe me stof tek bryli (gri)	Copë	1 (një)	1 (një)	1 (një)
11	Xhup impermeabel (blu)	Copë	1 (një)	1 (një)	1 (një)
12	Rrip mesi lëkure (i zi)	Copë	1 (një)	1 (një)	1 (një)
13	Bustinë me strehë stofi (blu)	Copë	2 (dy)	2 (dy)	2 (një)
14	Këpucë verore (të zeza)	Palë	1 (një)	1 (një)	1 (një)
15	Këpucë me qafa (të zeza)	Palë	1 (një)	1 (një)	1 (një)
16	Stemë krahut e plotë	Copë	1 (një)	1 (një)	1 (një)


UNIFORME VERORE



UNIFORME DOGANIERI



UNIFORME ANTIKONTRABANDE



ANEKSI II

EMBLEMA E SHERBIMIT DOGANOR SHQIPTAR



V E N D I M
Nr.532, datë 24.9.2001

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.439, DATË 4.8.2000, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË HUAJVE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 84 të ligjit nr.8492, datë 27.5.1999 “Për të huajt”, me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.439, datë 4.8.2000 të Këshillit të Ministrave bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 3 paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë vijon:

“Në komisaritet e policisë paraqiten ata të huaj, të cilëve u skadon afati i qëndrimit me vizë, e që dëshirojnë ta zgjasin këtë qëndrim ose kërkojnë të qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë mbi tre muaj, si dhe të huajt që hyjnë pa vizë e qëndrojnë më shumë se 30 ditë. Paraqitja në organet e policisë, në këto raste, bëhet jo më vonë se 10 ditë para se të mbarojë afati i vlerfshmërisë së qëndrimit të përfutur”.

2. Në pikën 9, pas paragrafit të dytë të shtohet paragrafi, që më poshtë vijon:

“Për shtetasit e huaj të cilët hyjnë në Republikën e Shqipërisë pa vizë, si dhe për ata të cilët marrin vizë në kufi, kohëqëndrimi në Republikën e Shqipërisë mund të zgjatet deri në 90 ditë, duke filluar nga data e hyrjes në kufirin shqiptar”.

3. Në pikën 10 bëhen këto ndryshime:

- Në fund të shkronjës “c” të shtohen fjalët: “...ose në vendin ku i interesuari ka pasur qëndrim të ligjshëm për gjashtëmuajorin e fundit.”.

- Në shkronjën “ç”, pas fjalëve “organet policore” të shtohen fjalët që më poshtë vijojnë: “...organet të tjera të administratës shtetërore, në vendin ku i interesuari ka pasur qëndrim të ligjshëm për gjashtëmuajorin e fundit ose nga përfaqësia diplomatike a konsullore e akredituar në Republikën e Shqipërisë”.

- Në fund të pikës 10 të shtohet paragrafi që më poshtë vijon:

“Specialistët e ardhur në kuadër të marrëveshjeve, dypalëshe e shumëpalëshe, lektorë, pjesëtarë të stafëve shkencore, pedagogë të universiteteve, që për shkak të njohurive të tyre të veçanta punojnë në Republikën e Shqipërisë, pajisen me lejeqëndrimi në bazë të kërkesës së tyre dhe konfirmimit të titullarit të institucionit qendror, në strukturën e të cilit ata janë të punësuar. Familjarët në ngarkim të tyre pajisen me lejeqëndrimi në Republikën e Shqipërisë në bazë të kërkesës së të interesuarit dhe të certifikatës familjare”.

4. Pas pikës 10 të shtohet pika 10/1 me përmbajtjen si vijon:

“Mund të pajisen me lejeqëndrimi, për motive bashkimi familjar:

- a) bashkëshorti/ja i/ e shtetasve shqiptarë, kur kërkon të banojë në Shqipëri;
- b) të afërm (nëna, babai) në ngarkim të shtetasit shqiptar dhe të bashkëshortit/es së tij;
- c) bashkëshorti/ja, fëmija(deri në moshën 18 vjeç) e shtetasve të huaj, i/e cili/a është rezident/e i/e ligjësuar në Republikën e Shqipërisë dhe kërkon të banojë në Shqipëri.

Në këto raste depozitohen aktet vijuese:

- Kërkesa e të interesuarit në Republikën e Shqipërisë;
- certifikata familjare;
- vërtetim nga gjykata se nuk ka padi të depozituar për zgjidhje martese në vendin ku gjendet rezident kërkuar i lejeqëndrimit.

Fëmijët nën moshën 18 vjeç regjistrohen në lejeqëndrimin e prindërve të tyre.

Aplikimi për bashkim familjar bëhen në komisaritet e policisë vendore.

5. Pas pikës 11 të shtohet pika 11/1 me këtë përmbajtje:

11/1 Aktet që kërkojnë për aplikim për lejeqëndrimi, të cilat janë lëshuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, pranohen kur janë të legalizuara nga përfaqësia jonë, diplomatike apo konsullore, në vendin ku ato janë marrë ose nga Drejtoria Juridike dhe e Çështjeve Konsullore, në Ministrinë e Punëve të Jashtme”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.534, datë 24.9.2001

**PËR TRAJTIMIN ME SHPËRBLIM TË PUNONJËSVE QË SHKURTOHEN NGA KALIMI
NË KONCENSION I MINIERËS SË KROMIT BULQIZË, FABRIKËS SË PASURIMIT
BULQIZË, IMPIANTIT TË SELEKSIONIMIT KLOS DHE UZINËS SË FERROKROMIT
BURREL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr.8562, datë 22.12.1999 “Për përcaktimin e formës dhe strukturës së formulës të privatizimit të shoqërisë anonime “Albkrom” dhe të nenit 4 të ligjit nr.8791, datë 10.5.2001 “Për miratimin e “Marrëveshjes së koncensionit të formës “ROT” të Minierës së Kromit Bulqizë, Fabrikës së Pasurimit Bulqizë, të Impiantit të Seleksionimit Klos, dhe të Uzinës së Ferrokromit Burrel ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe shoqërisë të së drejtës italiane “Darfo” s.p.a”, si dhe dhënies së disa stimuljeve dhe garancive për koncensionarin e kësaj Marrëveshjeje”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Punonjësve të njësisë së Minierës së Kromit Bulqizë, Fabrikës së Pasurimit Bulqizë, Impiantit të Seleksionimit Klos dhe Uzinës së Ferrokromit Burrel, të cilët shkurohen si rezultat i zbatimit të marrëveshjes së koncensionit, të miratuar me ligjin nr.8791, datë 10.5.2001, t’u jepet një shpërblim i barabartë me pagesën bazë të vendit të punës të 2 (dy) viteve. Fondet e nevojshme prej 248 000 000 (dyqind e dyzetë e tetë milionë) lekësh sigurohen nga koncensionari.

2. Shpërblimi i punonjësve të bëhet me 8 (tetë) këste; secili këst është 3 (tre) muaj. Pagesa e shpërblimit fillon nga data 16.7.2001.

3. Përfitojnë shpërblim të barabartë me pagën bazë të dy viteve punonjësit, të cilët kanë qenë në marrëdhënie pune, pandërprerje, në njësinë përkatëse që nga data 22.6.2000, punonjësit që nuk përfitojnë nga privatizimi i objekteve të veçanta të njërive respektive dhe punonjësit që nuk përfitojnë trajtim të veçantë, në mbështetje të ligjit nr.8685, datë 9.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera në nëntokë”.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.98, datë 27.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i ""
Gjergj Sauli	Anëtar i ""
Alfred Karamuço	Anëtar i ""
Kristofor Peçi	Anëtar i ""
Petrit Plloçi	Anëtar i ""
Tefta Zaka	Anëtare e ""
Sokol Sadushi	Anëtar i ""
Kujtim Puto	Anëtar i ""

me sekretare Arbenka Lalice, në datën 27.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.108 Akti që i përket:

KËRKUES: NDREKË RUKAJ, kandidat për deputet i Partisë Socialiste në zonën zgjedhore nr.4, përfaqësuar me prokurë nga avokat Preng Zefi.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

- 1.KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
2. Valentin Palaj, përfaqësuar me prokurë nga avokat Arben Ristani.
3. KOMISIONI i ZONËS ZGJEDHORE NR.4, përfaqësuar nga Njac Çapaliku.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.200, datë 25.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Në kërkesë janë parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e vendimit të sipërm:

1. Në të tre qendrat e votimit për të cilat Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur përsëritjen e zgjedhjeve, zgjedhjet janë zhvilluar normalisht dhe në përputhje me ligjin.
2. Në asnjë prej procesverbaleve të qendrave të votimit nuk janë pasqyruar vërejtje nga anëtarët e komisioneve të qendrave të votimit apo përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjo i relatorin e çështjes Kujtim Puto, përfaqësuesin e kërkuarit, subjektet e interesuara dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 200, datë 25.7.2001, ka vendosur të mos shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.4 dhe ka urdhëruar përsëritjen e zgjedhjeve në qendrën e votimit nr.7 të Komunës Velipojë (Reç) për kandidatin e drejtpërdrejtë dhe për subjektet politike, në qendrën e votimit nr.4 Barbullush dhe në qendrën e votimit nr.31 Pazar i Vjetër, vetëm për kandidatin e drejtpërdrejtë.

Ndryshe nga sa pretendon kërkuari, vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është i drejtë. Në qendrën e votimit nr.7 Velipojë nuk është zhvilluar fare votimi për shkak se u ndryshua vendndodhja e komisionit të qendrës së votimit nga fshati Reç në fshatin Rrjollë, pa miratimin përkatës, si dhe për dobësi të tjera organizative. Në këtë mënyrë, nuk iu dha mundësia zgjedhësve për të votuar. Moskryerja fare e votimit ndikon edhe për numrin e votave në ndarjen e mandateve plotësuese (proporcionalit), gjë që imponon zhvillimin përsëri të zgjedhjeve si për kandidatët, ashtu edhe për subjektet elektorale.

Mosrespektim të ligjit dhe dobësi të tjera organizative pati edhe në qendrën e votimit nr.4 Barbullush ku vendndodhja e qendrës së votimit ishte ndryshuar natën pa miratimin e komisionit më të lartë zgjedhor dhe pa dijeninë e përfaqësuesit të subjektit elektorale të "Bashkimit për Fitore". Po kështu, në qendrën e votimit nr.31, fletët e votimit ishin të vulosura më parë nga anëtarët e komisionit

dhe nuk u pranuan vëzhguesit e subjektit elektoral të Partisë Demokratike.

Të gjitha këto kanë ndikimin e tyre në rezultatin e zgjedhjeve në zonë, prandaj duhet përsëritur votimi.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 shkronjat "c", f", të Kushtetutës, në nenet 26 dhe 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", si dhe në nenin 113 pika 5 të Kodit Zgjedhor, njëzëri

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M Nr.100, datë 31.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Zija Vuci	Anëtar i	'''
Gjergj Sauli	Anëtar i	'''
Alfred Karamuço	Anëtar i	'''
Kujtim Puto	Anëtar i	'''
Petrit Plloçi	Anëtar i	'''
Tefta Zaka	Anëtare e	'''
Sokol Sadushi	Anëtar i	'''
Kristofor Peçi	Anëtar i	'''

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 30.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.110 Akti që i përket:

KËRKUES: MARK KRROQI, përfaqësuar nga avokat Bujar Hoti.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1.LEKË ÇUKAJ

2. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga Sokol Lamaj, me autorizim.

3. KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE Nr.2, përfaqësuar nga kryetari Ndue Dodaj.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.203, datë 25.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe shpallja e pavlefshme e votimeve të datës 22.7.2001 në qendrat e votimit nr.5 Abat; Nr.7 Nikaj; Nr.9 Menmavriq; Nr.14 Prekal, Nr.6 Benë dhe Nr.9 Toplan të zonës zgjedhore nr.2.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin Kristofor Peçi, përfaqësuesit e kërkesit dhe të subjekteve të interesuara dhe bisedoi çështjen,

V Ë R E N:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.203, datë 25.7.2001, ka shpallur rezultatin

përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.2, duke njohur si fitues kandidatin për deputet zotin Lekë Çukaj, përfaqësues i Partisë Socialiste.

Kërkuesi Mark Krroqi kërkon shfuqizimin e këtij vendimi dhe shpalljen të pavlefshëm të rezultatit në 6 qendra votimi, sipas objektit të kërkesës, me pretendimin se në to nuk është zhvilluar votimi. Për të argumentuar këtë pretendim të tij, kërkuesi paraqiti disa procesverbale e deklarata, sipas të cilave në gjashtë qendrat e përmendura nuk është zhvilluar fare votimi.

Por sipas tabelave të rezultateve që disponon Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe atyre të paraqitura nga subjekti i interesuar, rezulton se vetëm në qendrën e votimit të fshatit Toplan nuk janë zhvilluar votime, ndërsa në pesë qendrat e tjera të pretenduara votimet janë kryer dhe janë plotësuar tabelat e rezultateve. Mbi këtë bazë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka shpallur rezultatit përfundimtar.

Në këto rrethana, përderisa ekzistojnë dokumente të rregullta që vërtetojnë zhvillimin e votimeve dhe nxjerrjen e rezultatit në këto qendra votimi dhe se moskryerja e votimeve vetëm në një qendër votimi nuk ndikon në rezultatit përfundimtar, kërkesa duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131 të Kushtetutës, neneve 113 e 141 të Kodit Zgjedhor dhe të neneve 26, 66, 67 e 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M Nr.101, datë 31.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Zija Vuci	Anëtar i	""
Gjergj Sauli	Anëtar i	""
Alfred Karamuço	Anëtar i	""
Kristofor Peçi	Anëtar i	""
Kujtim Puto	Anëtar i	""
Petrit Plloçi	Anëtar i	""
Sokol Sadushi	Anëtar i	""
Tefta Zaka	Anëtare e	""

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 26.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.107 Akti që i përket:

KËRKUES: Bamir Topi, kandidat për deputet i koalicionit "Bashkimi për Fitore", përfaqësuar nga avokat Roland Samarxhi, me prokurë.

SUBJEKTE TE INTRESUARA:

- 1.KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga Sokol Lamaj
- 2.ZAMIRA ÇAKA, candidate për deputete e Partisë Socialiste, përfaqësuar nga avokat Mirash Martini.
- 3.KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE nr.35, përfaqësuar nga kryetari Bujar Nishani.

OBJEKTI:

Shfuqizimi i vendimeve nr.192, datë 23.7.2001 dhe nr.193, datë 23.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kërkuesi për shfuqizimin e vendimit nr.192, datë 23.7.2001 të Komisionit Qendror të zgjedhjeve ka parashtruar këto shkaqe:

- Vendimi i dhënë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është dhënë pa marrë në shqyrtim ankimin e paraqitur nga ana e jonë.

- Në qendrat e votimit nr.73, 84, 87, 89, 91, 92 dhe 99, gjatë rinumërimit, gjykata ka konstatuar se qeset jeshile të sigurisë ishin të hequra. Që në këtë moment gjykata nuk duhet të vazhdonte procesin e rinumërimit.

- Në qendrat e votimit nr.74, 75, 76, 79, 83,84 dhe 96 nuk janë gjetur kundërilet me numrat e serisë dhe fletët e votimit të papërdorura. Këto fletë votimi janë përdorur pjesërisht për të plotësuar në favor të kandidatës Zamira Çaka, duke hequr fletë votimi nga ato për kandidatin Bamir Topi. Heqja e fletëve të votimit për Bamir Topin në qendrat e votimit nr.73, 76, 79, 81 dhe 95 arrinin shifrën 271 vota.

- Në qendrat e votimit nr.74 dhe 76 kodet e fiksuara në procesverbalin e mbajtur nga gjykata janë të ndryshme me kodet e pasqyruara në procesverbalin e dorëzimit të kutive nga komisioni i zonës zgjedhore në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

- Në qendrat e votimit nr.73, 75, 79, 83, 84, 96 kutitë e votimit janë hapur nga poshtë, pa u prekur kodet, gjë kjo e provuar me regjistrime video.

- Në qendrën e votimit nr.73 nga gjykata është konstatuar se nga 750 fletë votimi të marra në dorëzim nga qendra e votimit nr.73 në kuti janë gjetur 756, pra 6 më tepër se ç'kishte në dispozicion qendra e votimit. Po në këtë qendër votimi i janë hequr 28 fletë votimi Bamir Topit dhe i janë shtuar 21 fletë votimi Zamira Çakës. Këto fletë votimi të shtuara janë vetëm me firmën e kryetarit të komisionit të qendrës së votimit, gjë kjo që vjen në kundërshtim me nenin 106/3 të Kodit Zgjedhor.

GJYKATA KUSHTUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Tefta Zaka, përfaqësuesin e kërkuesit, subjektet e interesuara, si dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Komisioni i zonës zgjedhore nr.35, me vendimin nr.40, datë 9.7.2001, shpalli deputet të drejtëpërdrejtë të kësaj zone kandidatin e koalicionit "Bashkimi për Fitore" zotin Bamir Topi.

Meqenëse, bazuar në nenin 107 të Kodit Zgjedhor, diferenca e votave ndërmjet dy kandidatëve është më e vogël sesa numri i votave të pavlefshme të regjistruara në këtë zonë zgjedhore, mbi kërkesën e kandidatës për deputete Zamira Çaka, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.169, datë 13.7.2001, ka vendosur njoftimin e Gjykatës së Rrethit të Tiranës për të kryer procedurën e rinumërimit të votave për kandidatët që konkurrojnë në zonën Zgjedhore nr.35.

Në raudin e dytë të zgjedhjeve, më 8.7.2001, rezultati midis dy kandidatëve ka qenë 5975 vota për Bamir Topin dhe 5912 votave për Zamira Çakën, rezultat mbi të cilin Komisioni i Zonës Zgjedhore shpalli fitues Bamir Topin.

Gjykata e Rrethit të Tiranës, bazuar në nenet 108, 109, 110 të Kodit Zgjedhor ka bërë rinumërimin e votave, sipas procedurave të përcaktuara ligjore.

Gjatë procedurës së hapjes së kutive të votimit, gjykata ka konstatuar parregullsi të cilat i ka fiksuar në procesverbalin e mbajtur nga kjo Gjykatë. Pretendimet e kërkuesit lidhur me parregullsinë e kutive të votimit janë mbështetur në procesverbalin e mbajtur nga Gjykata e Rrethit të Tiranës, nga rezultoni:

- Në qendrën e votimit nr.73, me hapjen e kutisë, gjykata ka konstatuar se zarfi jeshil ka qenë i hapur dhe fletët e votimit të vlefshme ishin jashtë zarfeve përkatës. Mungon fletorja e procesverbalit të qendrës së votimit dhe kundërilet.

- Sipas tabelës së qendrës së votimit, rezultoni se janë marrë në dorëzim 750 fletë votimi.

- Nga verifikimi fizik i fletëve të votimit dhe rinumërimi i tyre janë gjetur në kuti 756 fletë

votimi, pra 6 fletë votimi më tepër se numri i marrë në dorëzim.

Po në këtë qendër votimi nga 241 vota të vlefshme që rezultojnë në tabelë për kandidatin Bamir Topi, 14 fletë votimi janë nxjerrë të pavlefshme nga rivlerësimi i votave të vlefshme, ndërsa 15 fletë votimi më pak nuk rezultojnë të jenë nga rivlerësimi i fletëve të votimit të vlefshme për këtë kandidat.

Për kandidaten Zamira Çaka, nga 132 fletë votimi të vlefshme, sipas tabelës së qendrës së votimit, gjatë rinumërimit janë konstatuar 153 fletë votimi të vlefshme, pra 21 fletë votimi më tepër që nuk rezultojnë të jetë nga rivlerësimi i fletëve të pavlefshme në favor të kandidates Zamira Çaka. Gjykata ka konstatuar se 21 fletë votimi në favor të saj janë vetëm me një firmë, atë të kryetarit të qendrës së votimit.

Në qendrën e votimit nr.74 në procesverbalin e gjykatës, nga verifikimi i kodeve të kutisë së votimit rezultojnë se kodet e kutisë janë 239372 dhe 239293, ndërsa nga procerverbali i dorëzimit të kutive të votimit nga komisioni i zonës zgjedhore në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, numrat e kodeve janë 239283 dhe 239372, pra vjen prej kodeve është i ndryshëm nga ky procesverbal.

Në kutinë e votimit të qendrës së votimit nr.74, zarfi jeshil është i hapur dhe fletët e votimit, të vlefshme dhe të pavlefshme, nuk janë gjetur në zarfat përkatës.

Sipas procesverbalit të gjykatës mungon fletorja e procesverbalit të qendrës së votimit, si dhe mungojnë kundërfletët me numrat e serisë, fletët e papërdorura dhe të dëmtuara.

Në qendrën e votimit nr.76 kërkuesi ka pretenduar se kodet nuk janë të njëjta.

Nga procesverbali i gjykatës, pas verifikimit të kodeve, rezultojnë se numrat e kodeve të kutisë janë 238284 dhe 239300, ndërsa numrat e kodeve të kutisë së votimit, sipas procesverbalit të dorëzimit të kutive nga komisioni i zonës zgjedhore në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë 239284 dhe 239300, pra njeri prej kodeve është i ndryshëm nga ky procesverbal. Sipas procesverbalit përkatës, në kutinë e votimit nuk janë gjetur kundërfletët e papërdorura dhe të dëmtuara sipas tabelës së qendrës së votimit.

Nga rinumërimi ka rezultuar se në favor të kandidatit Bamir Topi janë gjetur 222 fletë votimi të vlefshme nga 308 fletë votimi të vlefshme të pasqyruara në tabelën e rezultateve të qendrës së votimit.

Nga procesverbali i gjykatës rezultojnë se 86 fletë votimi më pak për kandidatin Bamir Topi nuk rezultojnë nga rivlerësimi i fletëve të votimit të rinumëruara nga gjykata.

Në qendrën e votimit nr.79 nga procesverbali i gjykatës rezultojnë se mungon zarfi me kundërfletët dhe fletët e papërdorura, si dhe fletorja e procesverbalit.

Nga rinumërimi kanë rezultuar 356 fletë votimi të vlefshme, nga 368 fletë të shënuara në tabelën e qendrës së votimit për kandidatin Bamir Topi. Gjykata ka arritur në konkluzionin se nga 365 fletë votimi të gjetura në kuti nga rivlerësimi i votave të vlefshme ka rezultuar se 17 janë të pavlefshme, ndërsa 12 fletë votimi më pak për Bamir Topin nuk rezultojnë nga rivlerësimi, sipas procesverbalit të kësaj Gjykate.

Në qendrën e votimit nr.81 rezultojnë nga procesverbali i gjykatës se nuk ka procesverbal të qendrës së votimit. Nga procesverbali i gjykatës dhe i qendrës së votimit rezultojnë se në favor të kandidates Zamira Çaka janë 169 vota të vlefshme dhe në favor të kandidatit Bamir Topi janë 229 vota të vlefshme. Nga rinumërimi i votave ka rezultuar që në favor të kandidates të jenë 199 vota të vlefshme për secilin, nga të cilat 5 vota të vlefshme janë si rezultat i vlerësimit të votave të pavlefshme dhe 25 vota më pak për Bamir Topin e 25 vota më shumë për Zamira Çakën nuk rezultojnë të jenë nga rivlerësimi i votave të pavlefshme.

Nga procesverbali i gjykatës rezultojnë se 14 fletë votimi janë me një firmë.

Në qendrën e votimit nr.95, nga procesverbali i Gjykatës rezultojnë se zarfi me fletë votimi të pavlefshme dhe të dëmtuara mungon.

Për kandidaten Zamira Çaka, nga rinumërimi fizik rezultojnë të jenë 363 fletë votimi të vlefshme nga 340 fletë votimi të vlefshme të pasqyruara në tabelën e qendrës së votimit. Nga 363 fletë votimi të vlefshme, sipas procesverbalit, 22 fletë me një firmë dhe vulë.

Për kandidatin Bamir Topi, nga rinumërimi fizik rezultojnë të ketë 118 fletë votimi të vlefshme nga 139 fletë votimi të vlefshme të pasqyruara në tabelën e qendrës së votimit. Pra, 20 fletë votimi më pak për Bamir Topin nuk rezultojnë nga rivlerësimi i votave të vlefshme në favor të tij.

Në qendrat e votimit nr.79, 83, 84 dhe 96 mungojnë kundërfletët me numrat e serisë, fletët e papërdorura, fletoret e procesverbaleve dhe në dy qendra votimi edhe listat e zgjedhësve.

Për sa sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në konkluzionin që rezultatet e rinumërimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës nuk mund të merren si të besueshme dhe për pasojë akti i rinumërimit bëhet i pavlefshëm.

Në këto rrethana vendimi nr.192, datë 23.7.2001 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve duhet të shfuqizohet dhe të lihet në fuqi vendimi nr.40, datë 9.7.2001 i komisionit të zonës zgjedhore nr.35 që ka shpallur fitues zotin Bamir Topi. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbi bazën e rezultatit të vendimit nr.40, datë 9.7.2001 të Komisionit të Zonës Zgjedhore nr.35, duhet të shpallë rezultatin përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 dhe 132 të Kushtetutës, në nenin 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", si dhe në nenin 113 e vijues të Kodit Zgjedhor, me shumicë votash

V E N D O S I:

- Shfuqizimin e vendimit nr.192, datë 23.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe lënien në fuqi të vendimit nr.40, datë 9.7.2001 të komisionit të zonës zgjedhore nr.35, që ka shpallur fitues zotin Bamir Topi, kandidat për deputet i koalicionit "Bashkimi për Fitore".
- Detyrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të shpallë rezultatin përfundimtar.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

MENDIMI I PAKICËS

Jam kundër shumicës për këto arsye:

1. Sipas nenit 108 të Kodit Zgjedhor, numërimi i votave bëhet kryesisht kur diferenca midis dy kandidatëve është më e vogël se numri i përgjithshëm i votave të pavlefshme ose jo më shumë se 25 vota.

Në rastin konkret, diferenca midis dy kandidatëve ka qenë rreth 60 vota, pra më e vogël se votat e pavlefshme, prandaj nuk qëndron pretendimi i kërkuesit se nuk duhej bërë rinumërimi i votave, por të merrej në konsideratë rezultati i shpallur.

2. Procesi i rinumërimit të votave prej gjykatës është kryer në përputhje me ligjin.

Sikurse u konstatua gjatë gjykimin, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës, ka zbatuar të gjitha rregullat që parashikon neni 109 i Kodit Zgjedhor. Sipas pikës 6 të nenit 109, gjykata para fillimit të procesit, verifikon nëse janë dorëzuar të gjitha materialet nga komisioni i zonës zgjedhore ose të ndërpriste ato.

a) Derisa nuk rezultoi ndryshe nga gjykimi, mendoj se nuk qëndron pretendimi se kutitë e votimit ishin të hapura. Po të ishte kështu, gjykata nuk duhej të ndërmerre procedurat e rinumërimit.

b) Pretendimi se kutitë mund të hapen nga poshtë, nuk lidhet me rastin konkret, por si mundësi, gjë që nuk mund të shërbjë si argument për të vënë në dyshim rezultatin e votimit dhe të vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për këtë rast.

Gjykata ka bërë rinumërimin, duke e parë në të gjitha aspektet si: fletë votimet në kuti, fletë votimet e pavlefshme dhe mënyrën e ndarjes së votave sipas kandidatëve.

Në përfundim, Gjykata ka plotësuar tabelën e rinumërimit. Pas këtij veprimi, komisioni i zonës zgjedhore ka shpallur rezultatin nga ku rezultuar fituese Zamira Çaka. Rezultati i rinumërimit, për ato qendra votimi ku pretendohet se janë gjetur të hapura, nuk ka asnjë ndryshim me tabelat e rezultateve të këtyre qendrave.

Për fletë votimet që thuhet se janë gjetur jashtë kutisë, del se ato kanë qenë të papërdorura, pra s'janë llogaritur për asnjërin palë. Asnjë provë nuk paraqiti pala kërkuese se këto fletë votimi janë përdorur nga pala tjetër për të rritur votat në favor të saj.

Lidhur me mospërputhjen e kodeve në kuti të votimit mendoj se, kjo çështje u sqarua gjatë gjykimin. Në procesverbalin e gjykatës thuhet se kodet janë gjetur në rregull, por gabimisht 9 – ta është shkruar 8, pra është një lapsus. Nëse nuk do të kishte përputhje, gjykata nuk do të pranonte të bënte

rinumërimin ose së paku do ta citonte këtë fakt në procesverbalin e saj.

Pretendimi i kërkuarit se procesi i rinumërimit është zhvilluar pa praninë e kryetarit të komisionit të zonës zgjedhore dhe anëtarëve të Bashkimit për Fitore, është i pabazuar, pasi fillimisht ata kanë qenë të pranishëm, por janë larguar vetë pas hapjes së dy kutive të para.

Pra, largimi është bërë vullnetarisht dhe jo i imponuar nga gjykata. Bojkotimi i komisioneve dhe i procesit gjyqësor jo vetëm nuk duhet marrë në konsideratë për të vënë në dyshim procesin, por duhet cilësuar si një veprim antiligjor dhe i qëllimshëm për të penguar procesin zgjedhor, pjesë e të cilit është rinumërimi.

Ligji i detyronte ata të jenë të pranishëm, të nënshkruajnë procesverbalet dhe kundërshtimet t'i pasqyrojnë në procesverbal. Komisionerët, në rastin konkret, nuk i janë përmbajtur këtij detyrimi.

Veç sa më lart, kërkuari nuk arriti të vërtetojë pretendimet e tjera të tij.

Në këto kushte mendoj se kërkesa e kërkuarit duhej të rrëzohej.

KRYETARI

F.Abdiu

V E N D I M
Nr.103, datë 10.8.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Zija Vuci	Anëtar i	'''
Gjergj Sauli	Anëtar i	'''
Alfred Karamuço	Anëtar i	'''
Kristofor Peçi	Anëtar i	'''
Kujtim Puto	Anëtar i	'''
Sokol Sadushi	Anëtar i	'''
Petrit Plloçi	Anëtar i	'''
Tefta Zaka	Anëtare e	'''

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 10.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.88 Akti që i përket:

KËRKUES: GëZIM GOÇI, kandidat për deputet i Partisë Socialiste, përfaqësuar nga avokat Myrteza Myftari.

SUBJEKTE Të INTERESUARA:

1.KOMISIONI QENDROR i ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga Sokol Lamaj.

2. MUHAMET UKPERAJ, kandidat i pavarur për deputet i mbështetur nga PD+BF.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.996, datë 29.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe përsëritja e zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.10.

Kërkuari, për shfuqizimin e vendimit nr.996, datë 29.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka parashtruar këto shkaqe:

- 38 kuti votimi kanë ardhur në komisionin zonal të hapura dhe pa kod, në kundërshtim të hapur me Kodin Zgjedhor.

- Disa procesverbale të qendrave të votimit janë plotësuar nga e njëjta dorë.

- Në qendrën e votimit nr.2 Gështenjë, Komuna Kalinë, numri i votuesve del më i lartë se numri i zgjedhësve.

- Në disa qendra votimi procesverbalet janë me korrigjime.

- Në 20 qendra votimi listat janë shpallur më datë 23.6.2001.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Tefta Zaka, kërkuesin dhe përfaqësuesin e tij, subjektet e interesuara, si dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.996, datë 29.6.2001, ka shpallur rezultatin e zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.10, duke njohur si fitues kandidatin e pavarur për deputet zotin Muhamet Ukperaj, të mbështetur nga koalicioni "Bashkimi për Fitore". Pretendimi kryesor i kërkuesit për marrjen në dorëzim të 32 kutive të votimit të hapura nuk u provua gjatë gjykimit në këtë Gjykatë. Nga procesverbal i dorëzimit të materialeve zgjedhore nga komisioni i zonës zgjedhore nr.10 në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nuk rezulton që 32 kuti votimi të jenë marrë në dorëzim të hapura.

Gjithashtu nuk ka procesverbal të marrjes në dorëzim nga qendra e votimit në komisionin e zonës zgjedhore ku të jetë evidentuar ky fakt.

Përsa i përket ndryshimit të qendrës së votimit nr.3 në fshatin Matranxh nga objekt shtetëror në objekt privat, kërkuesi nuk provoi se çfarë ndikimi pati në rezultatin përfundimtar ky ndryshim, kërkesë kjo e nenit 113 shkronja "a" e Kodit Zgjedhor.

Lidhur me pretendimet e kërkuesit për votimin nga ana e personave që nuk kanë qenë prezent, për dhunën e ushtruar ndaj komisionerëve të qendrave të votimit, për nënshkrimin e procesverbaleve nga e njëjta dorë, për qëndrimin e kutive të votimit në mbi 15 orë në shtëpi private, në seancë gjyqësore nuk u paraqit asnjë provë nga ana e kërkuesit dhe mbetën vetëm në kuadrin e pretendimeve.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 shkronjat "e dhe f" të Kushtetutës, si dhe nenit 113 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

MENDIMI I PAKICËS

Kërkesa e kërkuesit Gëzim Goci, kandidat për deputet i Partisë Socialiste duhet të ishte pranuar për këto shkaqe:

- Në bazë të nenit 106/9 të Kodit Zgjedhor, çdo kuti votimi vulloset dhe numri identifikues i vulës regjistrohet në procesverbal. Kërkuesi ka ngritur pretendimin se 38 kuti votimi janë sjellë nga komisionet e qendrave të votimit të hapura dhe pa kod, duke përcaktuar në kërkesë dhe qendrat përkatëse të votimit. Për të provuar pretendimin e tij kërkuesi ka paraqitur para kësaj Gjykate provat e nevojshme, si një kërkesë e komisionit të zonës zgjedhore nr.10 drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, OSBE-së dhe ODIHR-it që mban datën 26.6.2001, ku midis të tjerave parashtrohet dhe pretendimi për 38 kuti votimi të marra në dorëzim të hapura nga komisioni i zonës zgjedhore. Kjo kërkesë është nënshkruar nga kryetari dhe tre anëtarë të komisionit të zonës zgjedhore nr.10.

Përveç sa sipër, në procesverbalin model 39/1, ku janë pasqyruar rezultatet e zonës zgjedhore nr.10, në pjesën vërejtje është shënuar edhe pretendimi për 38 kuti të hapura dhe për shpalljen të pavlefshme të zgjedhjeve në gjithë zonën. Gjithashtu në këtë procesverbal është pasqyruar edhe vërejtja për mospranimin e rezultatit në qendrën e votimit të fshatit Matranxh për shkak të ndryshimit të qendrës së votimit në kundërshtim me kërkesat e Kodit Zgjedhor, vërejtje këto që pa asnjë argument nuk janë pranuar nga pjesa tjetër e komisionit të zonës zgjedhore nr.10.

Pretendimet e tjera të kërkuesit, lidhur me faktin që numri i votuesve ishte më i madh se i zgjedhësve në disa qendra votimi, procesverbalet e disa qendrave të votimit ishin të nënshkruara nga e

njëjta dorë dhe të ndryshme nga ato të ndodhura në kuti, kërkonin një verifikim nga kjo Gjykatë. Kërkuesi për këto dy pretendime nuk mund të sillte prova të tjera, pasi tabelat dhe listat e votuesve ndodhen në kutitë e votimit.

Për të gjitha këto pretendime kërkuesi, brenda afate ligjore, i është drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i cili ka nxjerrë rezultatin përfundimtar, duke mos i marrë në konsideratë këto pretendime, por dhe duke mos i kthyer një përgjigje se për cilat shkaqe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk i merr në konsideratë ato.

Përsa sipër mendojmë se kërkesa e kërkuesit Gëzim Goci është e bazuar dhe duhej pranuar nga kjo Gjykatë.

Anëtar
S.Sadushi

Anëtare
T.Zaka

V E N D I M Nr.104, datë 31.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergj Sauli	Anëtar i ""
Alfred Karamuço	Anëtar i ""
Kristofor Peçi	Anëtar i ""
Kujtim Puto	Anëtar i ""
Sokol Sadushi	Anëtar i ""
Petrit Plloçi	Anëtar i ""
Tefta Zaka	Anëtare e ""
Zija Vuci	Anëtar i ""

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 31.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.111 Akti që i përket:

KËRKUES: Tritan Shehu, përfaqësuar nga avokat Artan Hajdari

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. PARTIA DEMOKRATE, përfaqësuar nga Sali Kelmendi.
2. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga Sokol Lamaj, me autorizim.

O B J E K T I:

Kundërshtimi i vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr.206, datë 27.6.2001.

BAZA LIGJORE: Neni 141 i Kodit Zgjedhor.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e vendimit:

Nga të dhënat del se 480 vota për kërkuesin Tritan Shehu dhe 360 vota për Partinë Demokrate si subjekt zgjedhor, padrejtësisht janë konsideruar të pavlefshme nga komisionerët e qendrave të votimit të zonës zgjedhore nr.35.

Sipas kërkuesve, të cilët pretendojnë se këto të dhëna i kanë siguruar nga vëzhguesit e tyre në këto qendra votimi, rezulton se në fakt të gjitha fletët i mësipërme të votimit janë të vlefshme.

Në këto rrethana ata i kërkojnë Gjykatës Kushtetuese që të hapen kutitë e votimit dhe pasi të bëhet verifikimi vetëm i këtyre fletëve të votimit të bëhet nga ana e saj rivlerësimi.

Në kërkesë theksohet se ky rivlerësim ka rëndësi vetëm për kandidatin Tritan Shehu, pasi subjekti politik që e ka mbështetur atë ka adaptuar një rregull sipas të cilit, përfiton nga lista

shumemërore ai kandidat që merr numrin më të madh të votave në konkurrimin si kandidat i drejtpërdrejtë.

Nga ana tjetër vihet në dukje se një gjë e tillë nuk sjell asnjë ndryshim në renditjen e partive politike si subjekte zgjedhore, për shkak se korrigjimet që kërkohen, janë me shifra kaq të vogla sa nuk ndikojnë në rezultatin e shpallur.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin Zija Vuci, kërkuesin dhe përfaqësuesin e tij, përfaqësuesin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Partia Demokrate dhe kandidati i saj për deputet në Kuvendin e Shqipërisë zoti Tritan Shehu kanë kundërshtuar vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke parashtruar se rezultati i shpallur prej tij nuk pasqyron realisht numrin e votave të fituara prej tyre si subjekte zgjedhore.

Për këtë, ata kanë pretenduar se shumë qendra votimi të zonës elektorale nr.35 kur është zhvilluar raundi i parë i zgjedhjeve në datën 24.6.2001, atyre u janë konsideruar padrejtësisht të pavlefshme një numër i madh fletësh votimi, ndonëse nga forma dhe përmbajtja e tyre nuk konstatohet asnjë lloj parregullsie.

Një pretendim të tillë kërkuesit e kanë mbështetur në vërejtjet me shkrim që kanë bërë vëzhguesit e tyre në modelarët përkatës të këtyre njërive zgjedhore.

Siç del edhe nga materialet që ndodhen në dosje, ata kanë reaguar menjëherë për zgjidhjen e këtij problemi. Brenda afateve ligjore kanë ushtruar të drejtën e ankimit duke iu drejtuar fillimisht komisionit zonal dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe më pas kanë shfrytëzuar edhe rrugën gjyqësore. I kanë kërkuar Gjykatës së Rrethit dhe më vonë edhe Gjykatës së Apelit të Tiranës hapjen e kutive të votimit dhe verifikimin vetëm të fletëve të votimit të deklaruara të pavlefshme nga komisionet e qendrave të votimit.

Megjithatë, secili prej këtyre organeve nuk ka pranuar të ndërmarrë këtë veprim, me arsyetimin se zgjidhja në themel e kësaj çështjeje nuk hyn në juridiksionin e tyre administrativ ose gjyqësor.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese çmon se është detyrë e saj që të investohet përfundimisht me shqyrtimin e kësaj kërkeje, përderisa kjo ka si objekt rivendosjen e një të drejte themelore që pretendohet se është shkelur dhe që konkretisht është e drejta për t'u zgjedhur.

Jo vetëm kaq, por përfshirja e saj për zgjidhje në juridiksion të kësaj gjykate diktohet edhe nga faktorë të tjerë, siç janë argumentet e nevojshme që kanë paraqitur kërkuesit për vërtetimin e pretendimeve të parashtruara si edhe legjitimitimi dhe interesi i tyre në ushtrimin e një kërkeje të tillë.

Ky interes është i lidhur me mënyrën e ndarjes së mandateve të fituara nëpërmjet sistemit proporcional, mënyrë kjo që është vendosur nga vetë Partia Demokrate si subjekt elektorale dhe që është miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Sipas këtyre kriterëve, renditja e kandidatëve të kësaj partie në listat shumëmbërore, bëhet sipas numrit të votave të fituara nga secili prej tyre në votimin e drejtpërdrejtë dhe fiton mandantin e deputetit ai që ka marrë më shumë vota, duke spostuar të tjerët që vijnë pas tij në listë.

Prandaj e vetmja rrugë për zgjidhjen e kësaj çështjeje është hapja e kutive të votimit, si dhe verifikimi dhe rivlerësimi i të gjitha fletëve të pavlefshme të votimit të zonës elektorale nr.35, por që i takojnë vetëm kërkuesit Tritan Shehu dhe partisë që e ka mbështetur atë.

Në bazë të nenit 167 pika 2 të Kodit Zgjedhor, kryerjen e këtyre veprimeve Gjykata Kushtetuese ia ngarkon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si organ i paanshëm dhe i specializuar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lindin gjatë procesit zgjedhor.

Nga ana tjetër, angazhimi i tij me këtë detyrë nuk përbën shkelje të rregullave të procedurës, përkundrazi eliminon disa veprime të tepërta e të panevojshme dhe afron më shumë kohën për shpalljen nga ky organ të rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131 të Kushtetutës,

V E N D O S I:

- Pranimin e kërkesës
- Urdhërimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të hapë kutitë e votimit të raundit të parë të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.35, të verifikojë vlefshmërinë e votave të pavlefshme të kandidatit për deputet Tritan Shehu e të Partisë Demokratë, si dhe në përfundim të shpallë rezultatin përfundimtar.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M

Nr. 111, datë 13.8.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Gjergji Sauli,	Anëtar i “““	
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““	
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““	
Petrit Plloçi,	Anëtar i “““	
Zija Vuci,	Anëtar i “““	
Tefta Zaka,	Anëtare e “““	
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““	

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 11.8.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.117 Akti që i përket:

KËRKUES: RAHMI MEHMETLLARI, kandidat për deputet i Partisë Socialiste, përfaqësuar nga Sokol Harizi

SUBJEKTE TË INTERESUARA: 1. ALFRED OLLI, kandidat për deputet i koalicionit “Bashkimi për Fitore”, përfaqësuar nga avokat Ilir Rusmajli.

2. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga Sokol Lamaj.

3. KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE nr.82, përfaqësuar nga Pëllumb Kulla.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimeve nr.219, datë 8.8.2001 dhe nr.221, datë 9.8.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe përsëritja e zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.10.

BAZA LIGJORE: Neni 141 i Kodit Zgjedhor.

Komisioni i zonës zgjedhore nr.82 ka vendosur të shpallë fitues kandidatin për deputet të Partisë Socialiste zotin Rahmi Mehmetllari. Mbi ankimin që ka bërë pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kërkuesi Alfred Olli ka kërkuar prishjen pjesërisht të vendimit të lartpërmendur dhe urdhërimin e përshtesës së zgjedhjeve për qendrat e votimit nr.17, 34, 35 e 36; ky i fundit ka marrë dy vendime. Me vendimin nr.219, datë 8.8.2001, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur të mos përfshijë në tabelën e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për zonën zgjedhore nr.82 qendrat e votimit nr.17, 34, 35 e 36; ndërsa me vendimin nr.221, datë 9.8.2001 ka vendosur të shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.82, duke njohur si fitues kandidatin për deputet të koalicionit “Bashkimi për Fitore” zotin Alfred Olli. Kundër këtyre vendimeve, ka bërë ankim kërkuesi, i cili ka kërkuar shfuqizimin e tyre, duke pretenduar:

- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe të nenit 18 pika 4 e tij.

- Ai organ ka vepruar si gjykatë, duke u shprehur se ka konstatuar nënshkrimin nga një person i vetëm për llogari të votuesve të tjerë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes kryetarin Fehmi Abdiu, kërkuesin e përfaqësuesin e tij, subjektet e interesuara, si dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Vendimet nr.219, datë 8.8.2001 dhe 221, datë 9.8.2001 janë të gabuara, prandaj si të tilla ato duhen të shfuqizohen.

Ka rezultuar, gjatë shqyrtimit të çështjes, se personi i interesuar, kandidati për deputet zoti Alfred Olli ka paraqitur ankim kundër vendimit të komisionit të zonës zgjedhore dhe ka kërkuar përsëritjen e zgjedhjeve për qendrat e votimit nr.17, 34, 35 e 36 të zonës zgjedhore nr.82.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ndonëse ka pranuar se në qendrat e votimit nr.17, 34, 35 e 36 gjatë procesit të votimit janë kryer shkelje të ligjit, që kanë ndikuar në rezultatet përfundimtare, nuk i ka deklaruar ato të pavlefshme, por, me vendimin nr.219, datë 8.8.2001, ka vendosur që të mos përfshijë në tabelën e rezultatit përfundimtar për zonën zgjedhore nr.82 rezultatit për 4 qendrat e votimit të lartpërmendura.

Ky qëndrim bie ndesh me përmbajtjen e nenit 113 shkronja “a” të Kodit Zgjedhor, sipas të cilit Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shpall të pavlefshme rezultatit e zgjedhjeve kur konstaton se janë vënë re shkelje të ligjit që kanë pasur ndikim në rezultatit përfundimtar. Pra, për sa kohë që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka krijuar bindjen se në ato 4 qendra votimi janë lejuar shkelje të ligjit, duhej t’i shpallte ato të pavlefshme dhe të urdhëronte përsëritjen e zgjedhjeve. Veç kësaj, referenca që ka bërë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve te neni 18 pika 4 është pa vend, sepse sipas tij, ai organ shpall rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, në bazë të rezultateve të shpallura nga Komisioni i Zonës Zgjedhore.

Duke mos përfshirë ato 4 qendra votimi në rezultatit përfundimtar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka dalë jashtë kompetencave të tij e, në këtë mënyrë, ka prekur të drejtën kushtetuese të votës së lirë të votuesve të atyre qendrave të votimit për të cilën bën fjalë neni 45 i Kushtetutës. Pas këtij vendimi, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kryer një shkelje tjetër të pasqyruar në vendimin nr.221, datë 9.8.2001, me të cilin ka shpallur fitues subjektin e interesuar zotin Alfred Olli.

Me këtë të fundit Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vepruar në kundërshtim me frymën e Kodit Zgjedhor dhe për një fakt tjetër se ka vendosur edhe jashtë (tej) kërkesës së kërkuesit që në fakt ka kërkuar deklarimin e pavlefshmërisë së zgjedhjeve dhe përsëritjen e tyre për ato 4 qendra votimi.

Në këto rrethana, të dy vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve duhet të shfuqizohen sepse janë në kundërshtim me ligjin.

Pavarësisht nga këto, gjatë shqyrtimit të çështjes është konstatuar se gjatë procesit të votimit në ato qendra votimi janë vënë re disa shkelje të ligjit. Kështu, numri i fletëve të votimit ka qenë më i madh se ai zgjedhësve; ato nuk kanë nënshkruar rregullisht në listat përkatëse e se vulat e kodeve janë gjetur të hapura.

Edhe me procesverbalin e mbajtur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Korçës është provuar se gjatë procesit të votimit në qendrat e votimit nr.17, 34, 35 e 36 janë konstatuar shkeljet e lartpërmendura, që kanë ndikimin e tyre në rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për zonën zgjedhore nr.82, prandaj del e nevojshme që atje të përsëriten zgjedhjet. Këtë atribut Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet ta përmbushë konform urdhërimeve të Kodit Zgjedhor. Pretendimi i subjektit të interesuar se gjykata Kushtetuese nuk duhet ta shqyrtojë vendimin nr.219, datë 8.8.2001 se gjykimi i këtij ankimi nuk është në juridiksionin e saj, është i pabazuar. Gjatë shqyrtimit të çështjes ka rezultuar se vendimet nr.219 dhe nr.221 kanë lidhje të ngushtë se ato kanë zgjidhur një problem të vetëm e se për ato Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është bazuar në një dispozitë të vetme.

Edhe pretendimi i kërkuesit për lënien në fuqi të vendimit të komisionit të zonës zgjedhore nr.82 që e ka shpallur atë fitues nuk qëndron, për aq sa është konstatuar se në 4 qendrat e lartpërmendura, procesi zgjedhor është zhvilluar, duke u lejuar disa shkelje të ligjit.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131 shkronja “e” të Kushtetutës, neneve 26 e 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, si dhe të nenit 113 pika 5 të Kodit Zgjedhor, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin e vendimit nr.219, datë 8.8.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me të cilin është urdhëruar të mos përfshihen në tabelën e rezultatit përfundimtar për zonën zgjedhore nr.82, qendrat e votimit 17,34,35 e 36.

- Shfuqizimin e vendimit nr.221, datë 9.8.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, lidhur me nxjerrjen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.82.

- Urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve në qendrat e votimit nr.17, 34, 35 e 36 të zonës zgjedhore nr.82, vetëm për listën njëemërore.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M

Nr.112, datë 13.8.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Anëtar i Gjykatës Kushtetuese	
Zija Vuci,	Anëtar i	“““
Alfred Karamuço,	Anëtar i	“““
Kristofor Peçi,	Anëtar i	“““
Petrit Plloçi,	Anëtar i	“““
Tefta Zaka,	Anëtare e	“““
Sokol Sadushi	Anëtar i	“““
Gjergj Sauli,	Anëtar i	“““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 11.8.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.118 Akti që i përket:

KËRKUES:LLESH KOLA, kandidat për deputet i koalicionit “Bashkimi për Fitore” në zonën zgjedhore nr.13 Lezhë, përfaqësuar nga avokatët Mirash Martini e Agim Ibrahim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
2. NIKOLLË LESI, përfaqësuar nga avokat Përparim Sanxhaku, me prokurë.
3. KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.13 LEZHË, në mungesë.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.220, datë 8.8.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.13

BAZA LIGJORE: Neni 141 i Kodit Zgjedhor

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Gjergj Sauli, kërkuesin e përfaqësuesit e tij, subjektet e interesuara, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N :

Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr.78, datë 9.7.2001, shfuqizoi vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr.012, datë 1.7.2001 për shpalljen e rezultatit përfundimtar të votimit në zonën zgjedhore nr.13 Lezhë dhe urdhëroi përsëritjen e zgjedhjeve të cilat u zhvilluan rregullisht në datën 29.7.2001.

Kërkuesi Llesh Kola, bazuar në nenin 108 të Kodit Zgjedhor në datën 31.7.2001, kërkoi të kryhej rinumërimi i fletëve të votimit nëpërmjet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Komisioni i zonës zgjedhore nr.13, pas përfundimit të procesit të rinumërimit të fletëve të votimit nga gjykata, shpalli fitues kandidatin Nikollë Lesi. Brenda afatit ligjor, kërkuesi u ankua kundër këtij vendimi në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, por ky komision, me vendimin nr.220, datë 8.8.2001, shpalli rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve dhe njohu fitues kandidatin Nikollë Lesi.

Me ankimin e paraqitur për shqyrtim, kërkuesi Llesh Kola e konsideron të paligjshëm vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr.220, datë 8.8.2001, duke pretenduar se gjykata ka shkelur dispozitat e Kodit Zgjedhor, sepse ka lejuar rinumërimin e fletëve të votimit në kutitë e hapura dhe në zarfet e hapura, ka quajtur të vlefshme fletët e votimit që kanë pasur shenja, se nuk ka bërë krahasimin e numrit të fletëve të votimit të përdorura me numrin e votuesve ose se ka quajtur të vlefshme votimet me certifikatë pa fotografi etj.

Pretendimet e mësipërme të kërkuesit u bënë objekt i shqyrtimit gjyqësor, por nuk rezultoi që prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Lezhës të jetë kryer ndonjë proces jo i rregullt ligjor. Përkundrazi, nga procesverbali i mbajtur prej kësaj Gjykate, që shqyrtoi çështjen e rinumërimit të votave në periudhën 2-4 gusht 2001, rezultoi se ajo ka pasur parasysh pretendimet e kërkuesit dhe për to është shprehur me vendim. Ky fakt tregon se gjykata në këtë proces ka ushtruar të gjitha kompetencat ligjore të përcaktuara në dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe vendimet e saj, sipas pikës 2 të nenit 112 të këtij Kodi, janë të formës së prerë.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese konkludon se kërkesa e paraqitur prej kërkuesit është e pabazuar dhe si e tillë duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131 shkronja “e” e 132 të Kushtetutës, neneve 26 e 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 141 pika 1 të Kodit Zgjedhor, njëzëri,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M Nr.114, datë 27.8.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergj Sauli	Anëtar i ""
Kristofor Peçi	Anëtar i ""
Kujtim Puto	Anëtar i ""
Petrit Plloçi	Anëtar i ""
Tefta Zaka	Anëtare e ""
Sokol Sadushi	Anëtar i ""
Zija Vuci	Anëtar i ""

me sekretare Drita Panda, në datën 27.8.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.120 Akti që i përket:

Kërkues:Ligoraq Karamelo, përfaqësuar nga avokati Bastri Mane

Subjekte të interesuara:

1. Arben Broja, kandidat për deputet i Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, përfaqësuar nga avokat Përparim Sanxhaku.

2. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përfaqësuar nga Sokol Lamaj.

3.Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, përfaqësuar nga Zana Pihiku.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.233, datë 21.8.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

BAZA LIGJORE: Neni 64 i Kushtetutës dhe nenet 81, 82 e 83 të Kodit Zgjedhor.

Për shfuqizimin e këtij vendimi kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe:

Lista shumemërore e kandidatëve për deputetë e përpiluar nga Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, është shqyrtuar dhe miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.793, datë 4.6.2001.

Nga ndarja e mandateve plotësuese, kësaj partie i takojnë tre vende në Kuvendin e Shqipërisë. Një nga këto vende sipas kërkuesit i takon atij, i cili figuron i treti në listën shumemërore. Mirëpo, në datën 1.8.2001 Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut ka njoftuar me shkresë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve se 23 kandidatë kanë dhënë dorëheqjen nga kandidimi, duke përfshirë aty dhe mërinë e kërkuesit. Por ky ka pretenduar se nuk ka dhënë dorëheqjen dhe se deklarata personale për dorëheqje e paraqitur në emrin e tij është falsifikuar. Ai ka thënë se për këtë ka bërë kallzim në prokurori, e cila ka vërtetuar me ekspertizë se ky dokument ishte krejtësisht i falsifikuar.

Në këto kushte, sipas tij, vendimi nr.233, datë 21.8.2001 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i cili duke u mbështetur në këtë dokument të falsifikuar shpall fitues të tretë të listës shumemërore zotin Arben Broja është haptazi në kundërshtim me Kushtetutën dhe Kodin Zgjedhor.

Prandaj ai i kërkon Gjykatës Kushtetuese të shfuqizojë këtë vendim dhe të urdhërojë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve që në vend të zotit Arben Broja të shpallë atë si deputet nga lista shumemërore.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Zija Vuci, kërkuesin e përfaqësuesin e tij, subjektet e interesuara, si dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kërkesa është e drejtë dhe duhet pranuar.

Gjatë shqyrtimit të saj në seancë plenare dhe nga provat shkresore që ndodhen në dosje u vërtetua se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në datën 4.6.2001 ka shqyrtuar dhe miratuar listën shumemërore të kandidatëve për deputetë që i ka paraqitur atij Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut. Në këtë listë, sipas renditjes, emri i kërkuesit Ligoraq Karamelo figuron i treti.

Në datën 1.8.2001 ky subjekt zgjedhor ka njoftuar me shkresë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve se 23 vetë nga kjo listë kanë hequr dorë nga e drejta e kandidimit për 40 mandatet plotësuese të Kuvendit. Së bashku me shkresën, këtij organi i janë dërguar edhe deklaratat personale për dorëheqje të këtyre personave, ku përfshihet edhe kërkuesi.

Mbi këtë bazë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi ka përcaktuar se kësaj partie i takojnë vetëm 3 mandate shtesë, në proporcion me numrin e votave të vlefshme të fituara në raundin e parë të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, me vendimin nr.233, datë 21.8.2001, ka shpallur fitues nga kjo listë zotërinjtë Vasil Melo, Vangjel Dule e Arben Broja, të renditur përkatësisht në numrat 1, 2 dhe 25 të kësaj liste, duke e skualifikuar kështu kërkuesin Ligoraq Karamelo, i cili figuron i treti sipas numrit rendor.

Ky vendim është i padrejtë vetëm në pjesën që shpall deputet të Kuvendit zotin Arben Broja.

Në këtë rast Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka shkelur kërkesat e pikës 1 të nenit 64 të Kushtetutës, si dhe të pikës 2 të nenit 91 të Kodit Zgjedhor.

Në këto dispozita është përcaktuar qartë se 40 deputetë të Kuvendit zgjidhen nga listat shumëmemërore të partive dhe/ose koalicionëve të partive sipas renditjes në to se, renditja e kandidatëve në listë caktohet nga partitë si subjekte zgjedhore dhe se në rast vdekjeje, dorëheqjeje ose humbjeje të së drejtës për të kandiduar të një kandidati të listë, vazhdohet me kandidatin pasues në renditje.

Duke iu referuar pjesës arsyetuese të këtij vendimi, të krijohet përshtypja se kjo renditje është respektuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, po të ishte e rregullt dorëheqja nga kandidimi i kërkuarit Ligoraq Karamelo, i cili siç u tha renditej i treti në listë.

Parregullsia e kësaj dorëheqjeje, të tij shfaqet në disa drejtime:

Në radhë të parë, edhe sikur ta ketë kërkuar vetë kërkuari, tërheqja e tij nga kandidimi në vështirësi të pikës 3 të nenit 83 të Kodit Zgjedhor, nuk i jep të drejtë askujt të bëjë ndryshime në emrat e listave shumëmemërore të vërtetuara.

Së dyti, me miratimin e këtyre listave, kandidatët e regjistruar në to fitojnë cilësinë e subjektit zgjedhor. Pra, janë vetë ata që disponojnë mbi të drejtën për t'u zgjedhur dhe jo partitë politike që i kanë mbështetur dhe i kanë përfshirë në këto lista. Dorëheqja e tyre nga e drejta e kandidimit në këtë fazë është një akt personal. Si e tillë është vetë kandidati ai që duhet t'i drejtohet me kërkesë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe jo partitë politike.

Për më tepër, kërkesa për dorëheqje në emër të kërkuarit e depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve duket mjaft e dyshimtë, madje nuk përjashtohet mundësia që ajo të mos pasqyrojë vullnetin e tij të vërtetë. Ai e ka kontestuar atë me forcë, sapo është vënë në dijeni të këtij fakti dhe ka denoncuar menjëherë çështjen në prokurori, e cila në rrugë zyrtare ka vërtetuar me ekspertë, ashtu siç ka pretenduar kërkuari falsitetin e këtij dokumenti.

Në këto rrethana, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk duhej të mbështetej në kërkesën e Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut dhe mbi këtë bazë të kapërcente numrin rendor të kërkuarit, duke shpallur fitues fitues në vend të tij subjektin e interesuar, Arben Broja, i cili vjen i 25-ti në listën shumëmemërore.

Pretendimi i avokatit të këtij të fundit se edhe deklarata që ka lëshuar në fillim kërkuari për pranimin e kandidaturës për deputet nuk përmban nënshkrimin e tij, është i pabazuar. Kjo për arsye se jo vetëm kërkuari, por as partia ku ai aderonte nuk e kanë kundërshtuar këtë fakt.

Nga ana tjetër, edhe akti i ekspertimit që ka marrë privatisht ky avokat për të mbështetur këtë pretendim nuk ka vlerë provuese për të rrëzuar përmbajtjen e aktit të ekspertimit të kryer mbi një dokument tjetër me urdhër të prokurorisë.

Po kështu, i pabazuar është pretendimi i kësaj partie i mbështetur ky edhe nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve se në marrëveshje me midis anëtarëve të saj është vendosur që kandidatët e regjistruar në listën shumëmemërore do të shpallen fitues jo sipas renditjes së tyre në listë, por sipas numrit të votave të fituara si kandidatë të drejtpërdrejtë.

Ky kriter në ndarjen e mandateve plotësuese nuk rezulton të jetë pasqyruar në kohë në ndonjë akt shkresor. Veç kësaj, zbatimi i tij nuk del t'i jetë kërkuar as Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me rastin e paraqitjes pranë tij listave shumëmemërore dhe brenda afateve të parashikuara nga neni 76 i Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

Lejimi i këtyre mangësive esenciale e bën të cenueshëm në këtë pjesë vendimin e sipërpërmendur të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131 shkronja "e" të Kushtetutës, neneve 26 e 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", si dhe nenit 113 pika 5 të Kodit Zgjedhor, njëzëri,

V E N D O S I:

Shfuqizimin e vendimit nr.233, datë 21.8.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në pjesën që shpall deputet për Kuvendin e Shqipërisë zotin Arben Broja dhe detyrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që në vend të tij të shpallë deputet zotin Ligoraq Karamelo.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M
Nr.115, datë 28.8.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Zija Vuci	Anëtar i	'''
Gjergj Sauli	Anëtar i	'''
Kujtim Puto	Anëtar i	'''
Kristofor Peçi	Anëtar i	'''
Tefta Zaka	Anëtar e	'''
Sokol Sadushi	Anëtar i	'''
Petrit Plloçi	Anëtar i	'''

me sekretare Drita Panda, në datën 27.8.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.121 Akti që i përket:

KËRKUES: BARDHYL LONDO, kandidat për deputet i koalicionit "Bashkimi për Fitore" në listën shumëmemërore, përfaqësuar nga avokat Ilir Rusmajli.

SUBJEKTE Të INTERESUARA:

1.LUAN MYFTIU, kandidat për deputet i koalicionit "Bashkimi për Fitore", përfaqësuar nga avokate Aldona Sulaj.

2. KOMISIONI QENDROR i ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga Sokol Lamaj.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.232, datë 21.8.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për shpalljen e listës së deputetëve të koalicionit "Bashkimi për Fitore", të cilët përfitojnë nga ndarja e mandateve plotësuese"

BAZA LIGJORE: Neni 141 i Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

Për shfuqizimin e vendimit të mësipërm të komisionit qendror të zgjedhjeve, kërkuesi ka parashtruar:

Vendimi nr.32, datë 21.8.2001 i komisionit qendror të zgjedhjeve është në kundërshtim me nenet 81 e 83 të Kodit Zgjedhor. Ky Komision ka konstatuar dorëheqjen e kandidatit të koalicionit "Bashkimi për Fitore", zotit Abaz Ermenji, i cili në listën shumëmemërore të koalicionit mban numrin 5, por zëvendësimin e tij nuk e ka bërë me kandidatin e radhës në listë, por ka kapërcyer listën duke shpallur deputet kandidatin me numër 32.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Petrit Plloçi, kërkuesin dhe përfaqësuesin e tij, subjektet e interesuara, si dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Me vendimin nr.232, datë 21.8.2001, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka shpallur listën e deputetëve të koalicionit "Bashkimi për Fitore", të cilët përfitojnë nga ndarja e mandateve plotësuese. Në këtë listë në numrin 14 është shpallur si deputet edhe i interesuari Luan Myftiu i cili në listën shumëmemërore të koalicionit "Bashkimi për Fitore" mbante numrin 32. Nga ana e tij kërkuesi Bardhyl Londo, i cili në listën shumëmemërore të koalicionit mban numrin 25, ka kërkuar shfuqizimin e vendimit

të mësipërm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, lidhur me shpalljen e deputetëve të interesuarit Luan Myftiu dhe shpalljen e tij si deputet në vend të të mësipërmit.

Gjykata Kushtetuese, pas shqyrtimit të pretendimeve përkatëse në seancë gjyqësore konkludon se kërkesa e kërkuarit Bardhyl Londo është e drejtë. Kështu, ka rezultuar se në bazë të Kodit Zgjedhor nr.83, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në datën 1.6.2001 ka miratuar listën shumëmemërore të koalicionit "Bashkimi për Fitoren", ku pjesëtarë të këtij koalicioni është edhe Partia e Ballit Kombëtar. Në këtë listë kërkuari mban numrin 25, ndërsa i interesuari numrin 32. Me rastin e shpalljes së listës së deputetëve të koalicionit "Bashkimi për Fitoren", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka konstatuar se kandidati i këtij koalicioni zoti Abaz Ermenji, i cili në listën shumëmemërore mban numrin 5, kishte dhënë dorëheqjen. Përveç kësaj, është konstatuar se disa nga kandidatët e listës shumëmemërore, të tillë si kandidatët Sali Berisha, Jozefina Topalli, Pjetër Arbnori, kishin fituar si kandidatë të drejtpërdrejtë. Në këto kushte Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, duke patur për bazë edhe rezultatin e proporcionalit ka shpallur listën e deputetëve të koalicionit. Duke patur parasysh kandidatët që kishin fituar, si dhe faktin se një kandidat kishte dhënë dorëheqjen, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, sipas radhës, duhet të shpallte deputet edhe kërkuarin Bardhyl Londo, i cili në listë mban numrin 25 e jo kërkuarin Luan Myftiu, i cili mban numrin 32. Duke vepruar në këtë mënyrë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vepruar në kundërshtim me nenin 81/2 të Kodit Zgjedhor. Sipas kësaj dispozite "Renditja e kandidatëve në listë caktohet nga subjekti zgjedhor që e paraqet atë. Në rast vdekjeje, dorëheqje ose humbje të të drejtës për të kandiduar të një kandidati të listës sipas këtij kodi, vazhdohet me kandidatin pasues në renditje". Në kuptim të kësaj dispozite, "kandidat pasues në renditjen" në listën shumëmemërore, të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pas heqjes së kandidatit që dha dorëheqjen, si dhe të kandidatëve që kishin fituar në zgjedhjet e drejtpërdrejta, ishte kërkuari Bardhyl Londo, i cili në listë mban numrin 25 e jo i interesuari Luan Myftiu, i cili mban numrin 32.

Në gjyq nga ana e të interesuarit u pretendua se sipas marrëveshjes së pative pjesëmarrëse të koalicionit "Bashkimi për Fitoren", ku bën pjesë edhe Partia e Ballit Kombëtar, në listën shumëmemërore kësaj të fundit i ishin përcaktuar vendet 5, 9, 13 e 17 dhe se po të vërtetoheshin raste që parashikon neni 81/2 i Kodit Zgjedhor, të tilla si vdekje, dorëheqje ose humbje të të drejtës për të kandiduar të një kandidati të listës, këto vende do të plotësoheshin me kandidatë të po kësaj partie. Në vazhdim të këtij pretendimi, i interesuari e quan të drejtë vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që ka shpallur atë deputet, duke kapërcyer kandidatin pasues në renditje. Pretendimi i mësipërm është në kundërshtim me Kodin Zgjedhor. Kështu, sipas nenit 81 e vijues të këtij Kodi për ndarjen e 40 mandateve plotësuese partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore apo sipas rastit koalicionit e partive, paraqesin në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve një listë kandidatësh.

Sipas këtyre dispozitave, renditja e kandidatëve në listë caktohet nga subjekti zgjedhor që e paraqet atë dhe se emrat e listës shumëmemërore nuk mund të ndryshohen. Në vështrim të këtyre dispozitave në rastin në shqyrtim, subjekti zgjedhor që ka paraqitur listën në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është koalicioni "Bashkimi për Fitoren" dhe jo secila parti pjesëmarrëse në këtë koalicion. Për pasojë, marrëveshja e partive u pretenduar nga i interesuari ka efekt për hartimin e listës shumëmemërore deri para se të vërtetohet kjo listë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, sipas nenit 83 të Kodit Zgjedhor. Pas kësaj, asnjë marrëveshje e partive të koalicionit nuk mund të ketë efekt mbi listën.

Përveç kësaj edhe po të ketë marrëveshje të partive të koalicionit për kapërcim të kandidatit pasues në renditje, në kundërshtim me paragrafin e dytë të nenit 81 të Kodit Zgjedhor, kjo marrëveshje është e pavlefshme sepse është në kundërshtim me ligjin. Partitë e koalicionit mund të bëjnë marrëveshje deri para miratimit të listës, ndërsa pas miratimit Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në përcaktimin e deputetëve fitues në proporcional, në bazë të Kodit Zgjedhor, duhet të mbështeten vetëm tek renditja e përcaktuar në këtë listë. Renditja në listë nuk mund të kapërcehet me anjë lloj marrëveshje që bëhet, pasi kjo listë është miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, sipas rregullave që parashikon Kodi Zgjedhor. Të pranosh të kundërtën do të thotë të ndryshosh rregullat e lojës gjatë lojës, gjë që është e palejueshme. Pikërisht këtë ndalon Kodi Zgjedhor në nenet 81/2 e 83/3.

Në këto rrethana, vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në pjesën që shpall deputet të Kuvendit të Shqipërisë zotin Luan Myftiu duhet të shfuqizohet.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131 të Kushtetutës, neneve 26 e 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", si dhe nenit 113 pika 5 të Kodit Zgjedhor, njëzëri,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin e vendimit nr.232, datë 21.8.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në pjesën që shpall deputet të Kuvendit të Shqipërisë zotin Luan Myftiu me detyrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që në vend të tij të shpallë deputet zotin Bardhyl Londo.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M
Nr. 116, datë 28.8.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Zija Vuci,	Anëtar i	“““
Kujtim Puto,	Anëtar i	“““
Kristofor Peçi,	Anëtar i	“““
Gjergj Sauli	Anëtar i	“““
Sokol Sadushi,	Anëtar i	“““
Petrit Plloçi,	Anëtar i	“““
Tefta Zaka,	Anëtare e	“““

me sekretare Drita Panda, në datën 28.8.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.122 Akti që i përket:

KËRKUES: BESNIK ALLAMANI, kandidat për deputet i Partisë Demokratë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE.
2. PARTIA DEMOKRATE.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.230, datë 21.8.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

BAZA LIGJORE: Neni 81 e 141/1 të Kodit Zgjedhor dhe neni 64 i Kushtetutës

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatoren Tefta Zaka dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.230, datë 21.8.2001, ka shpallur listën e deputetëve të Partisë Demokratë, të cilët përfitojnë nga ndarja e mandateve plotësuese për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, vendim i cili është kundërshtuar nga kërkuesi Besnik Allamani.

Në datën 28.8.2001 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me një kërkesë për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes kundër vendimit 5 nr.230, datë 21.8.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Në këto kushte çështja duhet të pushohet.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 shkronja “e” të Kushtetutës, neneve 26 e 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 141 të Kodit Zgjedhor, njëzëri,

V E N D O S I:

- Pushimin e gjykimit të çështjes.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 1.10.2001
Doli nga shtypi më 3.10.2001

Tirazhi: 4210 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2001

Çmimi: 200 lekë